



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 101

Tiranë – E premte, 15 maj 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 331, datë 13.5.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 291, datë 15.5.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik” 8877
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 332, datë 13.5.2026	Për disa shtesa në vendimin nr. 782, datë 7.10.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”, të ndryshuar..... 8878
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 333, datë 13.5.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar..... 8881
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 334, datë 13.5.2026	Për përcaktimin e formatit dhe të specifikimeve teknike të vulave të verifikimit kufitar, si dhe të rregullave praktike të vulosjes së dokumenteve të udhëtimit gjatë hyrje-daljeve në kufirin shtetëror..... 8938
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 335, datë 13.5.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 777, datë 15.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së Gardës së Republikës së Shqipërisë” 8941
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 336, datë 13.5.2026	Për krijimin, funksionimin dhe administrimin e fondit të gjelbër të pemëve, në kuadër të zhvillimit të territorit e të hapësirave publike..... 8942
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 337, datë 13.5.2026	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim, rruga kthesa e Bërdicës – Ura e Baçallëkut” 8944
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 13.5.2026	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Studim-projektim aksi rrugor Elbasan–Lekaj, korridori 8, ndërtim aksi rrugor Papër–Ura e Grykshit” 8947

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 339, datë 13.5.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 760, datë 13.12.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Zgjerimi i rrugës Elbasan–Përrenjas–Qafëthanë (faza III)’”	8950
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 340, datë 13.5.2026	Për një ndryshim në vendimin nr. 362, datë 5.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin të Bashkia Tiranë të njërive të banimit në ndërtesa (pallat)”	8951
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 341, datë 13.5.2026	Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së kompensimit për shoqëritë e linjave të transportit qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës në kushtet e situatës së veçantë në tregun hidrokarbur.....	8953
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 342, datë 13.5.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 182, datë 20.3.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e elementeve të sigurisë dhe çmimit të pullave fiskale”	8955
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 343, datë 13.5.2026	Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë, me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, si qiradhënëse, dhe shoqërisë “Aluflor” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë shtetërore nr. 10/211, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, dhe pasurinë shtetërore nr. 5/160/ND, në pronësi të shoqërisë “Petrol Alba” sh.a., në zonën kadastrale 8516, me vendndodhje në Durrës.....	8956
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 344, datë 13.5.2026	Për ngarkimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si autoritet kontraktor, për realizimin e fazës paraprake të projektit “Parku i Besimit”	8970
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 345, datë 13.5.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 646, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave e të kriterëve të përzgjedhjes së zhvilluesit në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar.....	8970
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 346, datë 13.5.2026	Për disa shtesa në vendimin nr. 649, datë 16.10.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, të ndryshuar.....	8973
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 347, datë 13.5.2026	Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2026.....	8974
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 348, datë 13.5.2026	Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat të arsimit të mesëm të lartë “Kryqi i Nderuar”, Gjirokastër.....	8981
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 13.5.2026	Për përcaktimin e masës së vlerës së dëmit dhe të dëmshpërblimit të pronarëve për kafshët e therura, të eliminuara, të shkatërruara e të groposura nga sëmundja e murtajës së ruminantëve të vegjël në vitin 2025.....	8982
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 350, datë 13.5.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 570, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, të ndryshuar.....	8983

Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe Gazit nr. 19, datë 9.5.2026	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	8984
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe Gazit nr. 20, datë 13.5.2026	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	8985



VENDIM
Nr. 331, datë 13.5.2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 291, DATË 15.5.2024,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E KUFIJVE MONETARË
NË PROCEDURAT E PROKURIMIT
PUBLIK”¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 33, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të pikës 2, të nenit 24, të ligjit nr. 88/2025, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 291, datë 15.5.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik, koncesionet dhe partneritetin publik privat”.

2. Në pikën 1, të kreut II “Kufijtë monetarë në sektorin klasik”, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në shkronjën “a”, togfjalëshi “... se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë” zëvendësohet me “... se vlera 528 781 400 (pesëqind e njëzet e tetë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind) lekë”;

b) Në shkronjën “b”, togfjalëshi “... se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë” zëvendësohet me “... se vlera 13 699 000 (trembëdhjetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) lekë”.

3. Në pikën 1, të kreut III “Kufijtë monetarë në kontratat sektoriale”, bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjën “a” togfjalëshi “... se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë” zëvendësohet me “... se vlera 528 781 400 (pesëqind e njëzet e tetë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind) lekë”;

b) Në shkronjën “b”, togfjalëshi “... se vlera 49 000 000 (dyzet e nëntë milionë) lekë” zëvendësohet me “... se vlera 42 271 200 (dyzet e dy milionë e dyqind e shtatëdhjetë e një mijë e dyqind) lekë”.

4. Pas kreut V shtohet kreu V/1, me këtë përmbajtje:

“KREU V/1

**KUFIRI MONETAR PËR KONCESIONET
DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT**

Kufiri minimal monetar për koncesionet dhe partneritetin publik privat është 5 000 000 (pesë milionë) lekë.”.

II. Dispozita kalimtare dhe të fundit

1. Procedurat e prokurimit publik të nisura me kufijtë monetarë para hyrjes në fuqi të këtij vendimi do të vijojnë të zhvillohen sipas kufijve të parashikuar në vendimin nr. 291, datë 15.5.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, në fuqi, në momentin e nisjes së tyre.

2. Ngarkohen autoritetet dhe entet kontraktore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të pikës 4, të kreut I, të këtij vendimi, e cila hyn në fuqi pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 88/2025, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

¹ Ky vendim është përafruar plotësisht me:

- direktivën 2014/24/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për prokurimin publik”, dhe që shfuqizon direktivën 2004/18/KE”, të ndryshuar, numri CELEX 32014L0024, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 94, datë 28.3.2014, f. 65–242;
- direktivën 2014/25/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për prokurimin nga subjektet që veprojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit

dhe shërbimeve postare dhe që shfuqizon direktivën 2004/17/KE”, të ndryshuar, numri CELEX 32014L0025, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 94, datë 28.3.2014, f. 243–374;

- direktivën 2014/23/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 26 shkurt 2014, “Për dhënien e kontratave koncesionare”, numri CELEX 32014L0023, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 94, datë 28.3.2014, f. 1–64.

**VENDIM****Nr. 332, datë 13.5.2026**

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN
NR. 782, DATË 7.10.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
MODELEVE TË AKTEVE KADASTRALE
DHE TË DHËNAVE NË PËRMBAJTJE
TË HARTËS KADASTRALE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, pika 5, 15, pika 3, e 17, pika 7, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 782, datë 7.10.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 4, të kreut II “Modeli dhe përmbajtja e kartelës së pasurisë së paluajtshme”, shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1. Përjashtimisht për pasuritë e paluajtshme të digjitalizuara, për shërbimet kadastrale që gjenerohen në mënyrë automatike nga baza shtetërore e të dhënave kadastrale dhe të ofruara përmes shërbimit elektronik publik, në përputhje me legjislacionin që rregullon identifikimin elektronik

dhe shërbimet e besuara dhe dokumentin elektronik, kartela kadastrale lëshohet me vulë elektronike të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, sipas aneksit 1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Ky dokument ka të njëjtën vlerë ligjore dhe fuqi provuese si çdo dokument tjetër zyrtar.”.

2. Pas pikës 10, të kreut III “Harta kadastrale dhe modeli i planit të rievimit”, shtohet pika 10/1, me këtë përmbajtje:

“10/1. Përjashtimisht për pasuritë e paluajtshme të digjitalizuara, për shërbimet kadastrale që gjenerohen në mënyrë automatike nga baza shtetërore e të dhënave kadastrale dhe të ofruara përmes shërbimit elektronik publik, në përputhje me legjislacionin që rregullon identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara dhe dokumentin elektronik, harta kadastrale gjenerohet me vulë elektronike, sipas aneksit 3/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Ky dokument ka të njëjtën vlerë ligjore dhe fuqi provuese si çdo dokument tjetër zyrtar.”.

3. Pas anekseve 1 dhe 3 shtohen përkatësisht anekset me numrat 1/1 dhe 3/1, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

II. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



ANEKSI 1/1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHËTËRORË E KADASTRËS
KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

		Kodi unik _____ (nga _____, në _____)															
A-TË DHENAT E PASURISË																	
Zona Kadastrale nr. _____,	Lloji i Pasurisë: _____,	Nr. i Pasurisë: _____, Sipërfaqja totale _____ m ² , (nga të cilat truall _____ m ² , ndërtesë _____ m ²)															
Indeksi i Hartës Kadastrale _____, Numri i pemëve: _____.																	
Adresa e pasurisë: Bashkia _____ Rruga _____ Ndërtesa nr. _____ SH/K _____ Apartamenti nr. _____																	
Vlera e pasurisë:																	
Fillestare _____ Lekë (akti nr. _____ dt. _____) Rmberësim _____ Lekë (akti nr. _____ dt. _____)																	
B-TË DHENAT E TITULLIT TË PRONËSISË																	
Pronari: _____ Nr. identifikimi/NIPT _____, Pjesa takuese ____ / ____																	
Emër _____ Atësi _____ Mbiemër _____																	
...vijon																	
Adresa e pronarit: Bashkia _____ Rruga _____ Ndërtesa nr. _____ SH/K _____ Apartamenti nr. _____																	
Akti i titullit të pronësisë: Emërtimi: _____ Nr. _____ Datë: _____																	
Regjistruar nr. _____ Datë: _____																	
*Pjesëmarrës në bashkëpronësi të detyrueshme për pasurinë nr. _____, me kod unik _____.																	
B/1-TË DHENAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK																	
Akti paraparak i titullit të pronësisë: Emërtimi: _____ Nr. _____ Datë: _____																	
Përshkrimi i objektit të aktit: _____																	
Regjistruar nr. _____ Datë: _____																	
C-TË DREJTAT REALE																	
Nr. regjistrimi	Dt. regjistrimi	Të dhënat e aktit <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <th style="width: 33%;">Lloji i të drejtës</th> <th style="width: 33%;">Emërtim</th> <th style="width: 33%;">Nr.</th> <th style="width: 33%;">Datë</th> </tr> <tr> <td> </td> <td> </td> <td> </td> <td> </td> </tr> </table>	Lloji i të drejtës	Emërtim	Nr.	Datë					Përfitues <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <th style="width: 60%;">Afati i vlefshmërisë</th> <th style="width: 40%;">Emër Atësi Mbiemër</th> <th style="width: 40%;">Nr. identifikimi / NIPT</th> </tr> <tr> <td> </td> <td> </td> <td> </td> </tr> </table>	Afati i vlefshmërisë	Emër Atësi Mbiemër	Nr. identifikimi / NIPT			
Lloji i të drejtës	Emërtim	Nr.	Datë														
Afati i vlefshmërisë	Emër Atësi Mbiemër	Nr. identifikimi / NIPT															
D-KUFIZIMET E PRONËSISË																	
Nr. regjistrimi	Dt. regjistrimi	Të dhënat e aktit <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <th style="width: 33%;">Lloji i kufizimit</th> <th style="width: 33%;">Emërtim</th> <th style="width: 33%;">Nr.</th> <th style="width: 33%;">Datë</th> </tr> <tr> <td> </td> <td> </td> <td> </td> <td> </td> </tr> </table>	Lloji i kufizimit	Emërtim	Nr.	Datë					Përfitues/Kërkuar <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <th style="width: 60%;">Afati i kufizimit</th> <th style="width: 40%;">Emër Atësi Mbiemër</th> <th style="width: 40%;">Nr. identifikimi / NIPT</th> </tr> <tr> <td> </td> <td> </td> <td> </td> </tr> </table>	Afati i kufizimit	Emër Atësi Mbiemër	Nr. identifikimi / NIPT			
Lloji i kufizimit	Emërtim	Nr.	Datë														
Afati i kufizimit	Emër Atësi Mbiemër	Nr. identifikimi / NIPT															
E-INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN																	
Lloji i informacionit _____ Emërtimi _____ Nr. _____ Datë: _____																	
Regjistruar nr. _____ Datë: _____																	
F-VEPRIMET ME KARTELEN E PASURISË																	
Veprimet me kartelën kryer nga _____ Veprimi me nr. regjistrimi _____ Datë: _____ Specialist _____																	

Vulesor elektronikisht nga Drejtoria
Vendore XXXX
Data ZZZZ/VV/XX 00:00:00 +00'00'
XXXXXXXXXXXXXXX999999999999A5H-X

Shënim: Ky dokument është generuar dhe vulesor me anë të një procedurë automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shqiptare e Kadashtësë)



ANEKSI 3/1

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA SHETERORE E KADASTRES

FRAGMENT I HARTES KADASTRALE

ZONA KADASTRALE: ____

KODI UNIK: ____


NUMRI PASURISE : ____

INDEX I HARTES: ____

X,Y

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X,Y



X,Y

SH 1: ____

X,Y

Vitecur elektronik i shitjes Dretoria
Vendore XXXX
Data: 2222/YY/XX 00:00:00 - 00:00
XXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXShënim : Ky dokument është gjeneruar dhe nënshkruar me anë
të një procedurë automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

SHpjegues

PARCELA
NDERTESA



VENDIM

Nr. 333, datë 13.5.2026

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E
SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË
KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN
PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE
SHFUQIZIMIN E MASAVE
SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË
NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun 1 bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Në pikën 7, pas fjalëve “... (CFSP) 2026/696 ...” shtohen “... (CFSP) 2026/614 ...”;

b) Në pikën 9 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i. Pas fjalëve “... (CFSP) 2024/2075 ...” hiqen “... (CFSP) 2025/690, (CFSP) 2025/774 ...”;

ii. Pas fjalëve “... (CFSP) 2025/1978 ...” shtohen “... (CFSP) 2026/762, (CFSP) 2026/774 ...”.

c) Në pikën 19 bëhen shtesat e mëposhtme:

i. Pas fjalëve “... (CFSP) 2024/1795 ...” shtohen “... (CFSP) 2025/690, (CFSP) 2025/774 ...”;

ii. Pas fjalëve “... (CFSP) 2026/645 ...” shtohen “... (CFSP) 2026/779 ...”.

ç) Në pikën 33, pas fjalëve “... (CFSP) 2025/1435 ...” shtohen “... (CFSP) 2026/897 ...”;

d) Në pikën 36, pas fjalëve “... (CFSP) 2026/254 ...” shtohen “... (CFSP) 2026/886 ...”;

dh) Pas pikës 44 shtohet pika 45, me këtë përmbajtje:

“45. Vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2011/173 “Lidhur me masat kufizuese në funksion të situatës në Bosnjë dhe Hercegovinë”, i ndryshuar, me vendimin e Këshillit (BE) 2026/763, sipas aneksit 45, bashkëlidhur këtij vendimi.”.

2. Në aneksin 7, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2026/614, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Në aneksin 9, bashkëlidhur vendimit, hiqen vendimet (CFSP) 2025/690, (CFSP) 2025/774 dhe shtohen vendimet (CFSP) 2026/762, (CFSP) 2026/774, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

4. Në aneksin 19, bashkëlidhur vendimit, shtohen vendimet (CFSP) 2025/690, (CFSP) 2025/774, (CFSP) 2026/779, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

5. Në aneksin 33, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2026/897, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Në aneksin 36, bashkëlidhur vendimit, shtohet vendimi (CFSP) 2026/886, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Pas aneksit 44, bashkëlidhur vendimit, shtohet aneksi 45, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



2026/614

16.3.2026

VENDIMI I KËSHILLIT (CFSP) 2026/614

i datës 16 Mars 2026

që ndryshon Vendimin 2014/145/CFSP lidhur me masat kufizuese në lidhje me veprimet që dëmtojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë,

Duke qenë se:

- (1) Më 17 mars 2014, Këshilli miratoi Vendimin 2014/145/CFSP⁽¹⁾.
- (2) Në përfundimet e tij të 19 dhjetorit 2024, Këshilli Evropian përsëriti dënimin e tij të vendosur të luftës së agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, e cila përbën një shkelje të qartë të Kartës së Kombeve të Bashkuara, dhe riafirmoi mbështetjen e tij të vazhdueshme për pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht. Këshilli Evropian deklaroi se përpjekjet për të kufizuar më tej aftësinë e Rusisë për të zhvilluar luftë duhet të vazhdojnë. Ai gjithashtu shprehu gatishmërinë e Bashkimit për të rritur presionin mbi Rusinë, duke përfshirë miratimin e sanksioneve të mëtejshme.
- (3) Duke pasur parasysh agresionin e vazhdueshëm dhe në rritje të Rusisë kundër Ukrainës, dhe në veçanti fushatën e saj të fundit brutale ushtarake që synon qëllimisht infrastrukturën civile, duke përfshirë energjinë, ujin dhe objektet shëndetësore, e cila ka shkaktuar vuajtje të rënda për popullsinë civile dhe që synon të minojë qëndrueshmërinë e Ukrainës, Këshilli e konsideron të nevojshme të miratojë masa të mëtejshme kufizuese.
- (4) Në veçanti, Këshilli konsideron se nëntë persona përgjegjës për veprime që dëmtojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës duhet të shtohen në listën e personave, subjekteve dhe organeve që i nënshtrohen masave kufizuese të përcaktuara në Shtojcën e Vendimit 2014/145/CFSP.
- (5) Prandaj, Vendimi 2014/145/CFSP duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Shtojca e Vendimit 2014/145/CFSP ndryshohet në përputhje me Shtojcën e këtij Vendimi.

⁽¹⁾Vendimi i Këshillit 2014/145/CFSP i 17 marsit 2014 në lidhje me masat kufizuese në lidhje me veprimet që dëmtojnë ose kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës (OJ L 78, 17.3.2014, f. 16, ELI):[http://data.europa.eu/eli/dhjetor/2014/145\(1\)/oj](http://data.europa.eu/eli/dhjetor/2014/145(1)/oj).



SHQIP

GZ L, 16.3.2026

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Nënshkruar në Bruksel, më 16 mars 2026.

Për Këshillin

Presidenti

K. KALLAS



GZ L, 16.3.2026

Shqip

SHTOJÇË

Personat e mëposhtëm i shtohen listës së personave, subjekteve dhe organeve të përcaktuara në Shtojcën e Vendimit 2014/145/CFSP:

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet	Data e listimit
"2023.	Aleksandr Yuryevich CHAYKO i njohur si Alexander Yuryevich CHAIKO Rusisht: Александр Юрьевич ЧАЙКО	Funksioni: Gjeneral Kolonel; Kryetar i Grupit të Forcave të Armatosura në Siri; ish-Komandant i Distriktit Ushtarak Lindor Data e lindjes: 27.7.1971 Vendi i lindjes: Golitsyno, Oblasti i Moskës, RFSFR, BRSS (tani Federata Ruse) Kombësia: Ruse Gjinia: Mashkull Numri i Identifikimit Tatimor: 503009120703	Aleksandr Chayko, kreu i Grupit të Forcave të Armatosura në Siri, është ish- Komandanti i Distriktit Ushtarak Lindor dhe ishte oficeri më i lartë ushtarak rus në terren në Ukrainë në fillim të pushtimit në shkallë të plotë të Rusisë. Alekandr Chayko ishte komandant kryesor në Ukrainë kur trupat ruse hynë në Bucha. Mizoritë në Bucha përbëjnë krime kundër njerëzimit dhe krime lufte. Alekandr Chayko u nderua me titullin "Hero i Federatës Ruse" në vitin 2020. Prandaj, Alekandr Chayko po mbështet veprime dhe politika që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, ose stabilitetin dhe sigurinë në Ukrainë.	16.3.2026
2024.	Andrey Viktorovich KONDROV Rusisht: Андрей Викторович КОНДРОВ	Funksioni: Kolonel, Komandant i Brigadës së 5-të të Tankeve të Veçanta të Ushtrisë së 36-të të Armëve të Kombinuar Data e lindjes: 12.8.1976 Vendi i lindjes: Dalnerechensk, Primorsky Krai, RFSFR, BRSS (tani Federata Ruse) Kombësia: Ruse Gjinia: Mashkull	Koloneli Andrey Kondrov është Komandanti i Brigadës së 5-të të Tankeve të Veçanta të Ushtrisë së 36-të të Armëve të Kombinuar. Kjo brigadë, e udhëhequr nga Andrey Kondrov, akuzohet për plaçkitje dhe vrasje të banorëve në Bucha. Ato mizori në Bucha përbëjnë krime kundër njerëzimit dhe krime lufte. Prandaj, Andrey Kondrov mbështet veprime dhe politika që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, ose stabilitetin dhe sigurinë në Ukrainë.	16.3.2026



Shqip

GZ L, 16.3.2026

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet	Data e listimit
2025.	Artem Igorevich GORODILOV Rusisht: Артем Игоревич ГОРОДИЛОВ	Funksioni: Kolonel; Komandant i Brigadës së 83-të Sulmuese Ajrore të Gardës; ish-Komandant i Regjimentit të 234-të Sulmuese Ajrore të Gardës të Divizionit të 76-të Sulmuese Ajrore të Gardës të Forcave Ajrore të Federatës Ruse Data e lindjes: 8.8.1984 Vendi i lindjes: Moskë, RSFSR, BRSS (tani Federata Ruse) Kombësia: Ruse Gjinia: Mashkull Pasaporta: seria 4507 Nr. 336855, lëshuar më 20.8.2004 nga qendra e punëve të brendshme në Moskë (Rajoni Sokolniki) Numri i Identifikimit Tatinor: 370203319194	Koloneli Artem Gorodilov është Komandanti i Brigadës së 83-të Sulmuese Ajrore të Gardës dhe ish-Komandant i Regjimentit të 234-të Sulmuese Ajrore të Gardës, i cili është pjesë e Divizionit të 76-të Sulmuese Ajrore të Gardës. Regjimenti i 234-të Sulmuese Ajrore i Gardës mori pjesë në një masakër të civilëve në Bucha kur ai qytet u pushtua nga trupat ruse në ditët e para të luftës. Artem Gorodilov udhëhoqi Regjimentin e 234-të Sulmuese Ajrore të Gardës në atë kohë dhe ishte i pranishëm në Bucha ku vdiqën qindra civilë, në disa raste si rezultat i ekzekutimeve brutale. Prandaj, Artem Gorodilov po mbështet veprime dhe politika që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, ose stabilitetin dhe sigurinë në Ukrainë.	16.3.2026



GZ L, 16.3.2026

Shqip

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet	Data e listimit
2026.	Sergey Viktorovich ЧУБАРЫКИН Rusisht: Сергей Викторович ЧУБАРЫКИН	Funksioni: General Major; Komandant i Divizionit të 76-të të Sulmit Ajror të Gardës së Forcave Ajrore të Federatës Ruse Data e lindjes: 25.8.1980 Vendi i lindjes: Ryazan, RSFSR, BRSS (tani Federata Ruse) Kombësia: Ruse Gjinia: Mashkull Pasaporta: seria 6102 Nr. 632261, lëshuar më 16.10.2002 Numri i Identifikimit Tatimor: 231523648681	Generalmajor Sergey Chubarykin është Komandanti i Divizionit të 76-të të Sulmit Ajror të Gardës, trupat e të cilit kryen shumicën e mizorive të dokumentuara në Bucha, duke përfshirë ekzekutime, tortura dhe plaçkitje. Këto mizori në Bucha përbëjnë krime kundër njerëzimit dhe krime lufte. Divizioni i 76-të i Sulmit Ajror të Gardës ishte në ballë të pushtimit të plotë të Ukrainës nga Rusia në shkurt 2022, me elementë të ndryshëm të divizionit që thuhet se u përfshinë në luftime në veri të Kievit, në Oblastin e Khar'kov pranë qytetit të Iziumit dhe në Oblastin lindor të Luhanskut rreth Popasnës. Prandaj, Sergey Chubarykin po mbështet veprime dhe politika që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, ose stabilitetin dhe sigurinë në Ukrainë.	16.3.2026
2027.	Viktor Viktorovich FILONOV Rusisht: Виктор Викторович ФИЛОНОВ aka Viktor Viktorovic FILONOV	Funksioni: Ushtar në Regjimentin e 234-të të Sulmit Ajror të Gardës të Divizionit të 76-të të Sulmit Ajror të Gardës të Forcave Ajrore të Federatës Ruse Data e lindjes: 9.4.1991 Vendi i lindjes: RSFSR, BRSS (tani Federata Ruse) Kombësia: Ruse Gjinia: mashkull	Viktor Filonov, ndërsa shërbente në Regjimentin e 234-të të Sulmit Ajror të Gardës të Divizionit të 76-të të Sulmit Ajror të Gardës, ishte i përfshirë në krimet e luftës të Rusisë kundër civilëve në Bucha dhe Borodianka, Oblast i Kievit, nga shkurti deri në mars 2022. Ai ka bërësuar një fëmijë nga Oblasti i Donetskut i pushtuar nga Rusia në lindje të Ukrainës, i cili u deportua ilegalisht në Rusi. Prandaj, Viktor Filonov mbështet veprime ose politika që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, ose stabilitetin dhe sigurinë në Ukrainë.	16.3.2026



Shqip

GZ L, 16.3.2026

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet	Data e listimit
2028.	Vladimir Viatcheslavovitch SELIVERSTOV Rusisht: Владимир Вячеславович СЕЛИВЕРСТОВ	Funksioni: General Major; ish- Komandanti i Divizionit të 106-të Ajror Data e lindjes: 18.1.1973 POB: Fshati Stanki, rrethi Vyaznikovsky, Oblast Vladimir, RSFSR, BRSS (tani Federata Ruse) Kombësia: Ruse Gjinia: Mashkull Adresa: Federata Ruse, Oblasti i Moskës, Kubinka, Rruga Armeyskaya 26, apartamenti 29 Pasaporta: seria 3418 Nr. 265658, lëshuar në vitin 2018	Generalmajor Vladimir Seliverstov i Forcave Ajrore Ruse komandoi njësitë e Divizionit të 106-të Ajror brenda Grupit të Trupave të Kombinuar "Vostok". Në periudhën shkurt deri në prill 2022, ai udhëhoqi veprimet e trupave vartëse gjatë operacionit rus për të pushtuar Kievin nga perëndimi. Personeli i këtyre njësive të Divizionit të 106-të Ajror ishte i përfshirë në krime lufte kundër civilëve në Oblastin e Kievit, duke përfshirë në Bucha, Hostomel dhe Irpen. Këto mizori përbëjnë krime kundër njerëzimit dhe krime lufte. Vladimir Seliverstov u nderua me titullin "Hero i Federatës Ruse". Prandaj, Vladimir Seliverstov po mbështet veprime dhe politika që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, ose stabilitetin dhe sigurinë në Ukrainë.	16.3.2026



GZ L, 16.3.2026

Shqip

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet	Data e listimit
2029.	Vadim Ivanovich PANKOV Rusisht: Вадим Иванович ПАНКОВ	Funksioni: Komandant i Brigadës së 45-të të Gardës së Veçantë për Qëllime Speciale (Spetsnaz) Data e lindjes: 2.1.1968 Vendi i lindjes: Gomel, RSS e Bjellorusisë, BRSS (tani Republika e Bjellorusisë) Kombësia: Ruse Gjinia: Mashkull	Generalmajor Vadim Pankov është Komandanti i Brigadës së 45-të të Gardës së Veçantë për Qëllime Speciale (Spetsnaz), e cila është pjesë e forcave elitare ajrore të Rusisë. Ai mori pjesë në aneksimin e Krimesë në vitin 2014, duke udhëhequr operacionet e forcave speciale. Vadim Pankov komandoi njësi gjatë pushtimit rus të Ukrainës. Brigada e tij ishte e përfshirë në pushtimin e Bucha. Ai akuzohet për urdhërimin e ekzekutimit të 30 banorëve vendas dhe detyrimin e civilëve për të larguar trupat e ushtarëve të vdekur rusë. Këto mizori përbëjnë krime kundër njerëzimit dhe krime lufte. Vadim Pankovit iu dha titulli "Hero i Federatës Ruse". Prandaj, Vadim Pankov mbështet veprime dhe politika që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, ose stabilitetin dhe sigurinë në Ukrainë.	16.3.2026
2030.	Denis Aleksandrovich SUVOROV Rusisht: Денис Александрович СУВОРОВ	Funksioni: Nënkolonel, Komandant i Batalionit të 175-të të Zbulimit të Veçantë të Divizionit të 76-të të Sulmit Ajror të Gardës të Forcave Ajrore të Federatës Ruse Data e lindjes: 6.11.1984 Vendi i lindjes: Oblasti i Pskov, RSFSR, BRSS (tani Federata Ruse) Kombësia: Ruse Gjinia: Mashkull	Nënkoloneli Denis Suvorov është Komandant i Batalionit të 175-të të Zbulimit të Veçantë të Divizionit të 76-të të Sulmit Ajror të Gardës. Në fillim të pushtimit në shkallë të plotë të Ukrainës nga Rusia, batalioni i tij u vendos si pjesë e operacioneve të divizionit në Oblastin e Kievit, përishirë Buçen. Aktivitetet e zbulimit të batalionit të tij mbështetën "operacionet në të gjerë të spastrimit" që qan në krime lufte të dokumentuara. Ai mori pjesë personalisht në torturimin e civilëve gjatë pushtimit rus të Buçes në mars të vitit 2022. Prandaj, Denis Suvorov po mbështet dhe zbaton veprime dhe politika që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, ose stabilitetin dhe sigurinë në Ukrainë.	16.3.2026



Shqip

GZ L, 16.3.2026

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet	Data e listimit
2031.	Aleksey Nikolaevich TOLMACHEV Rusisht: Алексей Николаевич ТОЛМАЧЕВ	Funksioni: Kolonel; Komandant i Regjimentit të 104-të Sulmues Ajror të Divizionit të 76-të Sulmues Ajror të Gardës të Forcave Ajrore të Federatës Ruse Data e lindjes: 23.4.1980 Vendi i lindjes: Moskë, RSFSR, BRSS (tani Federata Ruse) Kombësia: Ruse Gjinia: Mashkull Pasaporta: seria 6103 Nr. 814361, lëshuar më 8.4.2003 nga Departamenti i Punëve të Brendshme i Distriktit Hekurudhor Numri i Identifikimit Tatimor: 463205326671	Koloneli Aleksey Tolmachev, Komandanti i Regjimentit të 104-të Sulmues Ajror të Divizionit të 76-të Sulmues Ajror të Gardës, mori pjesë në pushtimin rustë Ukrainës. Nga shkurti deri në prill 2022, ai komandoi Regjimentin e 104-të Sulmues Ajror si pjesë e grupit të forcave "Vostok". Zona e tij e operacioneve ishte pjesa perëndimore e Oblastit të Kievit. Njësitë në varësi të Aleksey Tolmachev ishin të përfshira në kryerjen e krimeve të luftës kundër civilëve në qytetet Bucha dhe Irpen. Prandaj, Aleksey Tolmachev po mbështet veprime dhe politika që minojnë dhe kërcënojnë integritetin territorial, sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës; ose stabilitetin dhe sigurinë në Ukrainë.	16.3.2026.



2026/614

16.3.2026

COUNCIL DECISION (CFSP) 2026/614

of 16 March 2026

amending Decision 2014/145/CFSP concerning restrictive measures in respect of actions undermining or threatening the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 17 March 2014, the Council adopted Decision 2014/145/CFSP⁽¹⁾.
- (2) In its conclusions of 19 December 2024, the European Council reiterated its resolute condemnation of Russia's war of aggression against Ukraine, which constitutes a manifest violation of the Charter of the United Nations, and reaffirmed its continued support for Ukraine's independence, sovereignty and territorial integrity within its internationally recognised borders. The European Council stated that efforts to further limit Russia's ability to wage war must continue. It also expressed the Union's readiness to step up pressure on Russia, including by adopting further sanctions.
- (3) In view of Russia's continued and escalating aggression against Ukraine, and in particular its recent brutal military campaign deliberately targeting civilian infrastructure, including energy, water and health facilities, which has caused severe suffering to the civilian population and which aims to undermine Ukraine's resilience, the Council considers it necessary to adopt further restrictive measures.
- (4) In particular, the Council considers that nine persons responsible for actions undermining or threatening the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine should be added to the list of persons, entities and bodies subject to restrictive measures set out in the Annex to Decision 2014/145/CFSP.
- (5) Decision 2014/145/CFSP should therefore be amended accordingly.

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

The Annex to Decision 2014/145/CFSP is amended in accordance with the Annex to this Decision.

⁽¹⁾ Council Decision 2014/145/CFSP of 17 March 2014 concerning restrictive measures in respect of actions undermining or threatening the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine (OJ L 78, 17.3.2014, p. 16, ELI: [http://data.europa.eu/eli/dec/2014/145\(1\)/oj](http://data.europa.eu/eli/dec/2014/145(1)/oj)).



EN

OJ L, 16.3.2026

Article 2

This Decision shall enter into force on the date of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 16 March 2026.

For the Council

The President

K. KALLAS

—



OJ L 16.3.2026

EN

ANNEX

The following persons are added to the list of persons, entities and bodies set out in the Annex to Decision 2014/145/CFSP:

Name	Identifying information	Reasons	Date of listing
2023. Aleksandr Yuryevich CHAYKO a.k.a. Alexander Yuryevich CHAIKO Russian: Александр Юрьевич ЧАЙКО	Function: Colonel General; Head of the Armed Forces Group in Syria; former Commander of the Eastern Military District DOB: 27.7.1971 POB: Golitsyno, Moscow Oblast, RSFSR, USSR (now Russian Federation) Nationality: Russian Gender: male Tax Identification Number: 503009120703	Alexandr Chayko, head of the Armed Forces Group in Syria, is the former Commander of the Eastern Military District and was the most senior Russian military officer on the ground in Ukraine at the beginning of Russia's full-scale invasion. Alexandr Chayko was the lead Commander in Ukraine when Russian troops entered Bucha. The atrocities in Bucha constitute crimes against humanity and war crimes. Alexandr Chayko was awarded the title of "Hero of the Russian Federation" in 2020. Therefore, Alexandr Chayko is supporting actions and policies which undermine and threaten the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine, or stability and security in Ukraine.	16.3.2026
2024. Andrey Viktorovich KONDROV Russian: Андрей Викторович КОНДРОВ	Function: Colonel; Commander of the 5th Separate Tank Brigade of the 36th Combined Arms Army DOB: 12.8.1976 POB: Dalnerechensk, Primorsky Krai, RSFSR, USSR (now Russian Federation) Nationality: Russian Gender: male	Colonel Andrey Kondrov is the Commander of the 5th Separate Tank Brigade of the 36th Combined Arms Army. That brigade, led by Andrey Kondrov, is accused of looting and murdering residents in Bucha. Those atrocities in Bucha constitute crimes against humanity and war crimes. Therefore, Andrey Kondrov is supporting actions and policies which undermine and threaten the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine, or stability and security in Ukraine.	16.3.2026

ELL: <http://data.europa.eu/eli/dec/2026/614/oj>

3/8



EN

OJ L 16.3.2026

	Name	Identifying information	Reasons	Date of listing
2025.	Artem Igorevich GORODILOV Russian: Артём Игоревич ГОРОДИЛОВ	Function: Colonel; Commander of the 83rd Guards Air Assault Brigade; former Commander of the 234th Guards Air Assault Regiment of the 76th Guards Air Assault Division of the Airborne Forces of the Russian Federation DOB: 8.8.1984 POB: Moscow, RSFSR, USSR (now Russian Federation) Nationality: Russian Gender: male Passport: series 4507 No 336855, issued on 20.8.2004 by the centre of internal affairs in Moscow (Sokolniki District) Tax Identification Number: 370203319194	Colonel Artem Gorodilov is the Commander of the 83rd Guards Air Assault Brigade and the former Commander of the 234th Guards Air Assault Regiment, which is part of the 76th Guards Air Assault Division. The 234th Guards Air Assault Regiment participated in a massacre of civilians in Bucha when that city was occupied by Russian troops in the early days of the war. Artem Gorodilov led the 234th Guards Air Assault Regiment at the time and was present in Bucha where hundreds of civilians died, in some cases as a result of brutal executions. Therefore, Artem Gorodilov is supporting actions and policies which undermine and threaten the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine, or stability and security in Ukraine.	16.3.2026



OJ L 16.3.2026

EN

2026.	Name	Identifying information	Reasons	Date of listing
2026.	Sergey Viktorovich CHUBARYKIN Russian: Сергей Викторович ЧУБАРЫКИН	Function: Major General: Commander of the 76th Guards Air Assault Division of the Airborne Forces of the Russian Federation DOB: 25.8.1980 POB: Ryazan, RSFSR, USSR (now Russian Federation) Nationality: Russian Gender: male Passport: series 6102 No 632261, issued on 16.10.2002 Tax Identification Number: 231523648681	Major General Sergey Chubarykin is the Commander of the 76th Guards Air Assault Division, whose troops committed most of the documented atrocities in Bucha, including executions, torture and looting. Those atrocities in Bucha constitute crimes against humanity and war crimes. The 76th Guards Air Assault Division was at the forefront of Russia's February 2022 full-scale invasion of Ukraine, with different elements of the division reportedly involved in fighting north of Kyiv in Kharkiv Oblast near the city of Izyum and in the eastern Luhansk Oblast around Popasna. Therefore, Sergey Chubarykin is supporting actions and policies which undermine and threaten the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine, or stability and security in Ukraine.	16.3.2026
2027.	Viktor Viktorovich FILONOV Russian: Виктор Викторович ФИЛОНОВ a.k.a. Виктор Викторович ФИЛОНОВ	Function: Soldier in the 234th Guards Air Assault Regiment of the 76th Guards Air Assault Division of the Airborne Forces of the Russian Federation DOB: 9.4.1991 POB: RSFSR, USSR (now Russian Federation) Nationality: Russian Gender: male	Viktor Filonov, while serving in the 234th Guards Air Assault Regiment of the 76th Guards Air Assault Division, was involved in Russia's war crimes against civilians in Bucha and Borodianka, Kyiv Oblast, in February to March 2022. He has adopted a child from the Russian-occupied Donetsk Oblast of eastern Ukraine who was illegally deported to Russia. Therefore, Viktor Filonov is supporting actions or policies which undermine and threaten the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine, or stability and security in Ukraine.	16.3.2026

ELL: <http://data.europa.eu/eli/dec/2026/614/oj>

5/8



EN

OJ L, 16.3.2026

	Name	Identifying information	Reasons	Date of listing
2028.	Vladimir Vatcheslavovitch SELIVERSTOV Russian: Владимир Вячеславович СЕЛИВЕРСТОВ	Function: Major General: former Commander of the 106th Airborne Division DOB: 1.8.1973 POB: Stan'ki Village, Vyaznikovsky District, Vladimir Oblast, RSFSR, USSR (now Russian Federation) Nationality: Russian Gender: male Address: Russian Federation, Moscow Oblast, Kubinka, Armeyskaya Street 26, apt. 29 Passport: series 3418 No 265658, issued in 2018	Major General Vladimir Seliverstov of the Russian Airborne Forces commanded the units of the 106th Airborne Division within the "Vostok" Combined Troops Grouping. In the period February to April 2022, he led the actions of subordinate troops during the Russian operation to capture Kyiv from the west. The personnel of those 106th Airborne Division units were involved in war crimes against the civilians in Kyiv Oblast, including in Bucha, Hostomel and Irpen. Those atrocities constitute crimes against humanity and war crimes. Vladimir Seliverstov has been awarded the title of "Hero of the Russian Federation". Therefore, Vladimir Seliverstov is supporting actions and policies which undermine and threaten the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine, or stability and security in Ukraine.	16.3.2026



OJ L 16.3.2026

EN

	Name	Identifying information	Reasons	Date of listing
2029.	Vadim Ivanovich PANKOV Russian: Вадим Иванович ПАНКОВ	Function: Commander of the 45th Separate Guards Special Purpose Brigade (Spetsnaz) DOB: 2.1.1968 POB: Gomel, Belarus SSR, USSR (now Republic of Belarus) Nationality: Russian Gender: male	Major General Vadim Pankov is the Commander of the 45th Separate Guards Special Purpose Brigade (Spetsnaz), which is part of Russia's elite airborne forces. He participated in the annexation of Crimea in 2014, leading special forces operations. Vadim Pankov commanded units during Russia's invasion of Ukraine. His brigade was involved in the occupation of Bucha. He is accused of ordering the execution of 30 local residents and forcing civilians to remove the bodies of dead Russian soldiers. Those atrocities constitute crimes against humanity and war crimes. Vadim Pankov has been awarded the title of "Hero of the Russian Federation". Therefore, Vadim Pankov is supporting actions and policies which undermine and threaten the territorial integrity, sovereignty and independence of Ukraine, or stability and security in Ukraine.	16.3.2026
- a) 1 (një) pemë për çdo 30 (tridhjetë) m² sipërfaqe ndërtimi, por në çdo rast, jo më pak se 20 (njëzet) pemë për kat ndërtimi për të gjitha objektet rezidenciale dhe turistike, por jo më shumë se 500 (pesëqind) pemë për çdo leje ndërtimi;



b) 10 (dhjetë) pemë për çdo vilë apo shtëpi individuale banimi;

c) 10 (dhjetë) pemë për magazinat bujqësore dhe industriale;

ç) Për centralet e prodhimit të energjisë, 10 (dhjetë) pemë për mw, por jo më shumë se 500 (pesëqind) pemë për çdo leje ndërtimi.

3. Kontributi realizohet nëpërmjet dorëzimit, mbjelljes fizike të fidanëve dhe të pemëve në zonat e përcaktuara nga AZHT-ja, pas një procesi bashkërendimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Neni 5

Deklarata e përgjegjësisë

1. Para lëshimit të lejes së ndërtimit, sipas procedurave të legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe për zhvillimin e territorit, subjekti zhvillues depoziton një deklaratë përgjegjësie, me anë të së cilës angazhohet për përmbushjen e detyrimit për mbjellje të fidanëve dhe të pemëve, pranon kushtet e përcaktuara nga autoriteti përgjegjës i zhvillimit të territorit dhe garanton realizimin e detyrimit, brenda afateve të lejes.

2. Certifikata e përdorimit lëshohet nga autoriteti përgjegjës i zhvillimit të territorit, vetëm pasi të ketë marrë konfirmimin nga struktura përgjegjëse për gjelbërimin pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore për përmbushjen e detyrimit për mbjelljen e fidanëve dhe pemëve.

Neni 6

Detyrimi për shfrytëzimin e hapësirave publike

1. Çdo person fizik apo juridik, që pajiset me leje nga njësia e vetëqeverisjes vendore për shfrytëzimin e hapësirave publike, ka detyrimin të kontribuojë në fond.

2. Kontributi përcaktohet në raportin 1 (një) pemë për çdo tavolinë, në rastin kur kërkohet të vendosen karrike në hapësirën publike.

3. Kontributi fizik dhe raporti me numrin e tavolinave verifikohet nga strukturat përkatëse të bashkisë.

4. Kontributi realizohet në formë fizike, sipas këtij vendimi, ose duke paguar ekuivalentin e pemëve në lekë, në funksion të fondit të gjelbër të bashkisë përkatëse.

Neni 7

Administrimi i fondit

1. AZHT-ja, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, mban një regjistër të posaçëm elektronik, pjesë e sistemit *e-Lejë*, për:

a) fidanët dhe pemët e mbjella;

b) shpërndarjen e tyre sipas zonave të miratuara;

c) datën e mbjelljes;

ç) statusin e mirëmbajtjes.

2. Regjistri elektronik krijohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi të këtij vendimi.

Neni 8

Shpërndarja e fondit të fidanëve dhe të pemëve

1. Institucionet publike paraqesin kërkesë pranë AZHT-së për përfitimin e pemëve nga fondi pyjor, në funksion të zhvillimeve apo investimeve të tyre publike.

2. Kërkesa shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

a) relacioni për qëllimin e përdorimit dhe zhvillimit, i cili planifikohet të kryhet;

b) projekti përkatës publik;

c) të dhëna për vendndodhjen;

ç) të dhëna për numrin e pemëve.

3. AZHT-ja vendos për shpërndarjen e fidanëve dhe pemëve, duke marrë në konsideratë prioritetet e zhvillimit të territorit dhe nevojat publike për projekte të gjelbëruara.

Neni 9

Zbatimi

Ngarkohen Agjencia e Zhvillimit të Territorit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

Faqe | 8943

**VENDIM****Nr. 337, datë 13.5.2026****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIM,
RRUGA KTHESA E BËRDICËS – URA
E BAÇALLËKUT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim, rruga Kthesa e Bërdicës – Ura e Baçallëkut”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, “truall”, “pemëtores” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 57 455 087.10 (pesëdhjetë e shtatë milionë e katërqind e pesëdhjetë e pesë mijë e tetëdhjetë e shtatë pikë dhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 57 455 087.10 (pesëdhjetë e shtatë milionë e katërqind e pesëdhjetë e pesë mijë e tetëdhjetë e shtatë pikë dhjetë) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrotjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

[illegible]



23	Neship Shkëlqim Ermore	Qazim Qazim Qazim	Kastrati Kastrati Ivziku	1159	16/10	are	5,250.00	169.5	270	45,765.00											45,765.00	
24	Andis Andita	Beunik	Hallunaj Hallunaj	1159	16/9	are	2,000.00	59.70	270	16,119.00											16,119.00	
25	Idman Lindita	Cuf Sabri	Hali Hali	8591	17/615/ND	ndertese	82.80								82.8	2,260,771.20					2,260,771.20	
26	Marr Margerita	Albert Zef	Nikaj Nikaj	8591	18/812	truall	95.00				8.6	8,511.00	73,194.60								73,194.60	
27	Mefti	Rifat	Isufi	1159	16/58	are+truall	1,793.60				69.6	321.00	22,341.60								22,341.60	
28	Shavil	Ali	Behumi	1159	16/59	are+truall	1,252.50				79.1	321.00	25,591.10								25,591.10	
29	Xhush	Latif	Goska	8591	17/1443	truall	713.00				298.6	8,511.00	2,541,384.60								2,541,384.60	
30	Skender Ruzhdi Rauf Egrem Hilmi Can Jup Muhamet Servet Larje Satbere Arjet Arben		Hosha Hosha Hosha Hosha Bilani Bilani Bosha Bosha Bilani Bilani Bilani	8591	17/1272	truall	1,237.00				1166.7	8,511.00	9,929,783.70								9,929,783.70	
31	Detan Zamir	Qemal Qemal	Kruja Kruja	8591	18/728	truall	542.00				364	8,511.00	3,098,004.00								3,098,004.00	
32	Edmond Admir	Faik Muhamet	Hardalli Hardalli	8591	17/1257	truall	235.00				235	8,511.00	2,000,085.00								2,000,085.00	
33	Gëzim Jemira Jemir Elisa	Rapam Ramazan Ramazan	KrajaKraja Rragami	8591	17/944	ndertese	128.00										128.00	58,470.00	7,484,160.00		7,484,160.00	
34	Idman	Cuf	Hali	8591	17/1406	permton	8,338.50						303.60	270.00		81,972.00					81,972.00	
35	Qemil		Zela	8591	17/615	permton	164.90						37.50	270		10,125.00					10,125.00	
SHUMA TOTALE											269,757.00		47,324,433.90			115,965.00		2,260,771.20		7,484,160.00	57,455,087.10	



VENDIM

Nr. 338, datë 13.5.2026

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT “STUDIM-
PROJEKTIM AKSI RRUGOR ELBASAN-
LEKAJ, KORRIDORI 8, NDËRTIM AKSI
RRUGOR PAPËR-URA E GRYKSHIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Studim-projektim aksi rrugor Elbasan-Lekaj, korridori 8, ndërtim aksi rrugor Papër-Ura e Grykshit”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 14 667 525 (katërmëdhjetë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e njëzet e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 14 667 525 (katërmëdhjetë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e njëzet e pesë) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i

përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

10. Autoriteti Rrugor Shqiptar, pas miratimit të këtij vendimi, aplikon menjëherë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, e cila brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të vendimit, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për Autoritetin Rrugor Shqiptar për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për Autoritetin Rrugor Shqiptar për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE TË TË CILËVE PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “STUDIM- PROJEKTIM AKSI RRUGOR ELBASAN–LEKAJ, KORRIDORI 8 “NDËRTIM AKSI RRUGOR PAPËR–URA E GRYKSHIT”

NR	TË DHËNAT E PRONARIT			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT			Totali	Shënime
	Emër	Atësi	Mbiemër	Zona kadastrale	Nr.pasurie	Loji i pasurisë	Sipërfaqe totale	Sip. (m ²)	Arë Çmimi (leke/m ²)	Vlera (m ²)		
1	Hasan Ali Hysa			1195	897/1	Arë	4902	849	235	199,515.0	199,515.0	
2	Agim Ali Hysa			1195	896/1	Arë	6089	655	235	153,925.0	153,925.0	
3	Osman Sabri Hysa			1195	919/1	Arë	2303	433	235	101,755.0	101,755.0	
4	Mustafa Aqif Sinani			1872	36/12	Arë	1077	412	235	96,820.0	96,820.0	
5	Qemal Shaban Sinani			1872	36/13	Arë	3288	720	235	169,200.0	169,200.0	
6	Shaban Qemal Sinani			1872	36/14	Arë	2000	408	235	95,880.0	95,880.0	
7	Kalem Osman Sinani			1872	36/15	Arë	1223	666	235	156,510.0	156,510.0	
8	Kastriot Osman Sinani			1872	36/16	Arë	2000	799	235	187,765.0	187,765.0	
9	Bashkim Osman Sinani			1872	36/17	Arë	2347	435	235	102,225.0	102,225.0	
10	Ibrahim Osman Sinani			1872	36/18	Arë	2446	402	235	94,470.0	94,470.0	
11	Hekuran Idriz Sinani			1872	36/19	Arë	3579	1457	235	342,395.0	342,395.0	
12	Qemal Kasem Sinani			1872	36/20	Arë	9370	460	235	108,100.0	108,100.0	
13	Nure Rrahman Sinani			1872	36/21	Arë	2916	385	235	90,475.0	90,475.0	
	Pajtim Tafil Sinani											
	Lindita Tafil Sinani											
	Genci Tafil Sinani											
	Ermira Tafil Sinani											
	Vule Tafil Bullari (Sinani)											
	Vjollca Tafil Tabaku (Sinani)											
14	Alfred Ali Sinani			1872	36/22	Arë	2052	812	235	190,820.0	190,820.0	
15	Misir Ymer Sinani			1872	36/23	Arë	5421	777	235	182,595.0	182,595.0	
16	Besim Ymer Sinani			1872	36/24	Arë	4661	650	235	152,750.0	152,750.0	
17	Fatmir Shyqyri Sinani			1872	36/25	Arë	3000	1404	235	329,940.0	329,940.0	
18	Shyqyri Ymer Sinani			1872	36/26	Arë	8494	299	235	70,265.0	70,265.0	
19	Kadri Kamer Çehu			1872	36/27	Arë	2257	215	235	50,525.0	50,525.0	
20	Taulla Kadri Çehu			1872	36/28	Arë	2257	112	235	26,320.0	26,320.0	
21	Ramazan Kamer Çehu			1872	36/29	Arë	1000	215	235	50,525.0	50,525.0	
22	Haxhi Ramazan Sinani			1872	36/30	Arë	2000	173	235	40,655.0	40,655.0	
23	Frederik Jashar Sinani			1872	27/17	Arë	6347	472	235	110,920.0	110,920.0	
24	Zyri Jashar Sinani			1872	27/18	Arë	5000	288	235	67,680.0	67,680.0	
25	Jashar Zyri Sinani			1872	27/19	Arë	2116	159	235	37,365.0	37,365.0	
26	Nexhat Erfon Sinani			1872	27/20	Arë	5935	265	235	62,275.0	62,275.0	
27	Sadush Hasan Sinani			1872	27/21	Arë	7673	435	235	102,225.0	102,225.0	
28	Xhevahir Tahir Sinani			1872	27/22	Arë	3349	213	235	50,055.0	50,055.0	
29	Mersin Tahir Sinani			1872	27/23	Arë	5081	263	235	61,805.0	61,805.0	
30	Nazmi Nebi Sinani			1872	27/24	Arë	3924	131	235	30,785.0	30,785.0	
31	Bujar Nebi Sinani			1872	27/25	Arë	2182	101	235	23,735.0	23,735.0	
32	Shpetim Nebi Sinani			1872	27/26	Arë	2450	129	235	30,315.0	30,315.0	
33	Nebi Rahman Sinani			1872	27/27	Arë	1958	138	235	32,430.0	32,430.0	
34	Mesut Rahman Sinani			1872	27/28	Arë	4032	302	235	70,970.0	70,970.0	
35	Avni Mesut Sinani			1872	27/29	Arë	3200	195	235	45,825.0	45,825.0	
36	Resmi Mesut Sinani			1872	27/30	Arë	3200	257	235	60,395.0	60,395.0	
37	Qani Reshit Sinani			1872	27/31	Arë	4723	276	235	64,860.0	64,860.0	
38	Jakup Reshit Sinani			1872	27/32	Arë	4143	275	235	64,625.0	64,625.0	
39	Nazif Reshit Sinani			1872	27/33	Arë	4690	57	235	13,395.0	13,395.0	
40	Agim Reshit Sinani			1872	27/35	Arë	5114	12	235	2,820.0	2,820.0	
41	Ramazan Nexhip Sinani			1872	27/36	Arë	6246	540	235	126,900.0	126,900.0	
42	Ruzhdi Nexhip Sinani			1872	27/37	Arë	4530	446	235	104,810.0	104,810.0	
43	Beshet Caush Sinani			1872	27/38	Arë	4195	448	235	105,280.0	105,280.0	
44	Ramazan Kamer Çehu			1872	27/39	Arë	2400	216	235	50,760.0	50,760.0	
45	Haxhi Ramazan Çehu			1872	27/40	Arë	4052	450	235	105,750.0	105,750.0	
46	Kadri Taulla Çehu			1872	27/41	Arë	4707	358	235	84,130.0	84,130.0	
47	Taulla Kadri Çehu			1872	27/42	Arë	4705	331	235	77,785.0	77,785.0	
48	Emiljan Sadush Sinani			1872	21/45	Arë	700	700	235	164,500.0	164,500.0	
49	Mehedi Sefer Sinani			1872	21/3	Arë	4830	658	235	154,630.0	154,630.0	
50	Asllan Sefer Sinani			1872	21/46	Arë	3510	639	235	150,165.0	150,165.0	
51	Orkida Xhevdet Sinani			1872	21/48	Arë	1000	151	235	35,485.0	35,485.0	
52	Tauland Zabiti Sinani			1872	21/49	Arë	836	474	235	111,390.0	111,390.0	
53	Zabiti Sefer Sinani			1872	21/53	Arë	227	30	235	7,050.0	7,050.0	
	Kushe Tahir Sinani											



	Natasha Zabit Merko								
54	Ike Mesut Sinani Ndriçim Osman Sinani Flora Osman Salla Dashuri Osman Elezi Vladimir Osman Sinani Xhemile Osman Dushku Iljaz Osman Sinani	1872	21/6	Arë	3892	358	235	84,130.0	84,130.0
55	Hyqmet Hasan Sinani	1872	21/7	Arë	2882	448	235	105,280.0	105,280.0
56	Hamit Hasan Sinani	1872	21/8	Arë	3298	444	235	104,340.0	104,340.0
57	Izet Hasan Sinani	1872	21/9	Arë	2838	430	235	101,050.0	101,050.0
58	Myftar Qamil Sinani	1872	21/10	Arë	6681	845	235	198,575.0	198,575.0
59	Aqif Metan Sinani	1872	21/11	Arë	3990	564	235	132,540.0	132,540.0
60	Mustafa Aqif Sinani	1872	21/12	Arë	2124	621	235	145,935.0	145,935.0
61	Meslim Aqif Sinani	1872	21/13	Arë	3990	230	235	54,050.0	54,050.0
62	Qemal Shaban Sinani	1872	21/14	Arë	4705	654	235	153,690.0	153,690.0
63	Shaban Qemal Sinani	1872	21/15	Arë	2100	337	235	79,195.0	79,195.0
64	Ibrahim Osmon Sinani	1872	21/16	Arë	5569	1109	235	260,615.0	260,615.0
65	Bashkim Osman Sinani	1872	21/17	Arë	4687	942	235	221,370.0	221,370.0
66	Hekuran Idriz Sinani	1872	21/18	Arë	7068	1587	235	372,945.0	372,945.0
67	Murat Muharrem Sinani	1872	21/20	Arë	1515	342	235	80,370.0	80,370.0
68	Agron Muharrem Sinani	1872	21/21	Arë	2442	615	235	144,525.0	144,525.0
69	Artur Qerim Sinani	1872	21/22	Arë	3941	1577	235	370,595.0	370,595.0
70	Tasim Latif Sinani	1872	20/1	Arë	5125	436	235	102,460.0	102,460.0
71	Asqeri Latif Sinani	1872	20/26	Arë	1759	291	235	68,385.0	68,385.0
72	Myrteza Latif Sinani	1872	20/27	Arë	1759	362	235	85,070.0	85,070.0
73	Baki Haxhi Sinani	1872	20/3	Arë	3022	475	235	111,625.0	111,625.0
74	Haxhi Dalip Sinani	1872	20/4	Arë	2992	297	235	69,795.0	69,795.0
75	Vath Haxhi Sinani	1872	20/5	Arë	2992	410	235	96,350.0	96,350.0
76	Dalip Haki Sinani	1872	20/6	Arë	4493	500	235	117,500.0	117,500.0
77	Nevrus Haki Sinani	1872	20/7	Arë	4487	458	235	107,630.0	107,630.0
78	Selman Haki Sinani	1872	20/8	Arë	2873	437	235	102,695.0	102,695.0
79	Ibrahim Ismail Sinani	1872	20/9	Arë	700	700	235	164,500.0	164,500.0
80	Isuf Ibrahim Sinani	1872	20/10	Arë	4979	603	235	141,705.0	141,705.0
81	Shaqir Ibrahim Sinani	1872	20/11	Arë	7827	1053	235	247,455.0	247,455.0
82	Muharrem Shahin Sinani	1872	20/12	Arë	4644	561	235	131,835.0	131,835.0
83	Kujtim Asllan Sinani	1872	20/13	Arë	3129	504	235	118,440.0	118,440.0
84	Asllan Sadik Sinani	1872	20/14	Arë	6196	727	235	170,845.0	170,845.0
85	Zabit Nezir Sinani	1872	20/15	Arë	5118	601	235	141,235.0	141,235.0
86	Refik Nezir Sinani	1872	20/16	Arë	6388	647	235	152,045.0	152,045.0
87	Sami Sali Sinani	1872	20/17	Arë	5455	574	235	134,890.0	134,890.0
88	Rakip Seit Sinani	1872	20/28	Arë	2750	482	235	113,270.0	113,270.0
89	Tajar Rakip Sinani	1872	20/19	Arë	1493	663	235	155,805.0	155,805.0
90	Sadush Seit Sinani	1872	20/20	Arë	5580	417	235	97,995.0	97,995.0
91	Ylli Halit Sinani	1872	14/4	Arë	2572	438	235	102,930.0	102,930.0
92	Hajrie Iljaz Sinani Albert Hysni Sinani Ramazan Hysni Sinani Fatime Hysni Kokuja Ardjan Hysni Sinani Betul Hysni Sinani Defrim Hysni Sinani Sokol Hysni Sinani Flora Hysni Uruçi	1872	14/5	Arë	5386	674	235	158,390.0	158,390.0
93	Albert Hysni Sinani	1872	14/6	Arë	3825	533	235	125,255.0	125,255.0
168	Albert Hysni Sinani	1872	14/7	Arë				0.0	0.0
94	Ardian Hysni Sinani	1872	14/7	Arë	720	277	235	65,095.0	65,095.0
95	Ramazan Hysni Sinani	1872	14/8	Arë	2295	233	235	54,755.0	54,755.0
96	Kamer Met Sinani	1872	14/9	Arë	5054	811	235	190,585.0	190,585.0
97	Ramiz Met Sinani	1872	14/10	Arë	4479	481	235	113,035.0	113,035.0
98	Nazmi Met Sinani	1872	14/11	Arë	4480	508	235	119,380.0	119,380.0
99	Skender Zylyf Sinani	1872	14/12	Arë	8769	1284	235	301,740.0	301,740.0
100	Refik Nezir Sinani Zabit Nezir Sinani Nazmije Nezir Subashi Zybejta Nezir Daja Xhemal Nezir Sinani Dashamir Nezir Sinani Tushe Sabit Sinani	1872	14/13	Arë	4936	784	235	184,240.0	184,240.0
101	Xhemal Nezir Sinani	1872	14/14	Arë	3600	686	235	161,210.0	161,210.0
102	Ali Nuredin Sinani	1872	8//1	Arë	3763	622	235	146,170.0	146,170.0
103	Rexhep Nuredin Sinani	1872	8//2	Arë	3325	631	235	148,285.0	148,285.0
104	Riza Shefit Sinani	1872	8//3	Arë	2585	424	235	99,640.0	99,640.0
105	Faik Riza Sinani	1872	8//4	Arë	3816	671	235	157,685.0	157,685.0
106	Bedri Qerim Sinani	1872	8//5	Arë	5724	959	235	225,365.0	225,365.0
107	Sabri Zenel Sinani	1872	8//6	Arë	2911	495	235	116,325.0	116,325.0
108	Gezim Sabri Sinani	1872	8//7	Arë	2585	348	235	81,780.0	81,780.0



109	Ilmi Sabri Sinani	1872	8//8	Arë	1811	294	235	69,090.0	69,090.0	
110	Gani Selim Sinani	1872	8//9	Arë	4670	755	235	177,425.0	177,425.0	
111	Jemin Gani Sinani	1872	8//10	Arë	2085	488	235	114,680.0	114,680.0	
112	Nyzejene Refat Koçiu	1872	8//17	Arë	891	166	235	39,010.0	39,010.0	Kontratë pjesëtimi vullnetar nr. 871, rep. nr. 562/1 kol., datë 8.8.2016/kontratë hipotekimi nr. 1025 rep., nr. 652 kol., datë 31.8.2018, me vlerën 4000000.00 lekë Fondi Besa sh.p.k. nr. dok. 0218, datë regjistrimi 27.4.2022, vendoset masë sekuestrore me nr 251-06, regji., datë 27.4.2022, përmbartues gjyqësor privat në favor të Fondit Besa.
113	Refat Bajram Sinani	1872	8//18	Arë	2166	435	235	102,225.0	102,225.0	
	Naze Sefer Sinani									
	Hamide Refat Uruçi									
	Lindita Refat Cani									
	Arben Refat Sinani									
114	Bajram Rifat Sinani	1872	8//12	Arë	2155	210	235	49,350.0	49,350.0	
115	Petrit Rifat Sinani	1872	8//13	Arë	1117	308	235	72,380.0	72,380.0	
116	Hajdar Bajram Sinani	1872	8//14	Arë	3396	748	235	175,780.0	175,780.0	
117	Olsi Sadi Sinani	1872	6//15	Arë	5493	917	235	215,495.0	215,495.0	
118	Dilave Hasan Sinani	1872	6//16	Arë	5176	799	235	187,765.0	187,765.0	
119	Fatmire Ali Sinani	1872	6//17	Arë	4781	738	235	173,430.0	173,430.0	
	Mirela Shefqet Tabaku									
	Hasan Shefqet Sinani									
	Armis Shefqet Sinani									
120	Ndriçim Osman Sinani	1872	6//18	Arë	3180	508	235	119,380.0	119,380.0	
121	Tomorr Gani Sinani	1872	6//19	Arë	4341	742	235	174,370.0	174,370.0	
Vlera Totale									14,667,525	

VENDIM**Nr. 339, datë 13.5.2026**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 760, DATË 13.12.2024,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT ‘ZGJERIMI I
RRUGËS ELBASAN–PËRRENJAS–
QAFËTHANË (FAZA III)’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 760, datë 13.12.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Zgjerimi i rrugës Elbasan–Përrenjas–Qafëthanë (faza III)’”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pikat 3 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 14 724 608 (katërmbëdhjetë milionë e shtatëqind e njëzet e katër mijë e gjashtëqind e tetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 14 724 608 (katërmbëdhjetë milionë e shtatëqind e njëzet e katër mijë e gjashtëqind e tetë) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.”

b) Në tabelën, që i bashkëlidhet vendimit, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

i. të dhënat për shpronësim të numrit rendor 10 të tabelës, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me të dhënat me të njëjtin numër rendor sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ii. tabelës, bashkëlidhur vendimit, i shtohen pasuritë me numra rendorë 14–22 sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

iii. togfjalëshi “Vlera totale 684 342” zëvendësohet me “Vlera totale 14 724 608”.

2. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor



Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Librazhd, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Elbasan dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILËT SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “ZGJERIMI I RRUGËS ELBASAN–PËRRENJAS–QAFËTHANË (FAZA III)” (NDRYSHIMI DHE SHITESAT)

Nr. rendor	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)					Vlerësimet për shpronësim										Shënime
	Emër	Atësi	Mbiemër	Adresa	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe totale	Shpronësimi “arë”			Shpronësimi “truall”			Shpronësimi “ndërtësë”			Totali	
									Sip. (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (m²)	Sip. (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (m²)	Sip. (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera me preventiv punimesh		
10	Xhemal	Musa	Hasani	Mirakë	2696	56	Arë	1283	36	174	6,264							6,264	
14	Rexhep	Qemal	Hasani	Mirakë	2629	54	Arë	952	143	174	24,882							24,882	
15	Sulejman	Sherif	Hasani	Mirakë	2629	55	Arë	1395	221	174	38,454							38,454	
16	Qani	Abedin	Hasani	Mirakë	2696	57	Arë	1370	152	174	26,448							26,448	
17	Osman	Ismail	Tola	Mirakë	2696	77	Arë	2173	241	174	41,934							41,934	
18	Xhemal	Murat	Tola	Mirakë	2696	86	Arë	1393	18	174	3,132							3,132	
19	Xhemal	Murat	Tola	Mirakë	2696	95	Arë	637	319	174	55,506							55,506	
20	Xheladin	Muhamet	Tola	Mirakë	2696	100	Arë	606	40	174	6,960							6,960	
21	Hysen	Islam	Tola	Mirakë	2696	108	Arë	1007	2	174	348							348	
22	Softëlli	Koli	Bualli	Mirakë	2696	147/3	Truall	242	242	240	58,080	500.9					13,778,780	13,836,860	

VENDIM

Nr. 340, datë 13.5.2026

VENDOSI:

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 362, DATË 5.6.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN TE BASHKIA TIRANË TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESE (PALLAT)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 19, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

1. Lista e inventarit, bashkëlidhur vendimit nr. 362, datë 5.6.2024, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me listën e inventarit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



Lista e Inventarit të Objekteve të Përfunduara në Zonën “5 Maj” (të Kolauduara)

Nr.	Emërtimi i Kontratës	Vlera e Objektivit sipas Kontratës(Ndërtim+Montim+Projektim)	Vlera e Situacionit Përfundimtar (Ndërtim+Montim)	Vlera e Studium Projektim	Vlera e Mblidhjes së Punimeve	Vlera e Kolauditimit të Punimeve	Vlera Totale	Sipërfaqe Total Ndërtimi (m2)	Sipërfaqe Banimi Ap. (m2)	Sipërfaqe e Njësie të Shërbimit	Sipërfaqja e Katit -1	Hapësirë e Përhapshkët (kat -1 + kat perdithe+katë banimi +katëz asensor+ pandus+pasazh)	Ap.1+1	Ap.2+1	Ap.3+1	Total Apartamente (Nr)
1	Baneshë kolektive, godina 15A (Seksioni I)	573,665,006.00	562,682,984.80	10,975,603.00	5,640,000.00	228,250.00	579,526,837.80	12,357.00	6,221.50	1,143.90	2,989.50	2,002.10	11	31	15	57
2	Baneshë kolektive, godina 18	563,001,100.00	546,048,885.40	16,950,000.00	4,714,049.15	189,000.00	567,901,934.55	12,531.00	7,596.00	1,052.00	2,920.00	963.00	33	57	12	102
3	Baneshë kolektive, godina 12 (Seksioni C)	439,257,843.00	422,947,820.34	7,081,334.00	3,780,000.00	130,000.00	433,939,154.34	9,471.00	5,431.00	1,043.00	1,996.00	1,001.00	25	30	15	70
TOTAL		1,575,923,949	1,531,679,691	35,006,937	14,134,049	547,250	1,581,367,927	34,359	19,249	3,239	7,906	3,966	69	118	42	229

**VENDIM****Nr. 341, datë 13.5.2026**

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE,
TË DOKUMENTACIONIT DHE TË
MASËS SË KOMPENSIMIT PËR
SHOQËRITË E LINJAVE TË
TRANSPORTIT QYTETËS,
RRETHQYTETËS DHE NDËRQYTETËS
NË KUSHTET E SITUATËS SË
VEÇANTË NË TREGUN
HIDROKARBUR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14, të ligjit nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. TË PËRGJITHSHME**

1. Kompensimin e shoqërive të transportit për linjat qytetëse, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse, në masën 50 (pesëdhjetë) lekë për liter karburanti, për një periudhë trimujore: mars, prill, maj 2026. Kompensimi bëhet për shumën e konsumimit të karburantit për periudhën mars, prill, maj 2026, por jo më shumë se sasia e konsumuar për të njëjtën periudhë të vitit 2025, për secilën nga shoqëritë.

2. Efektet financiare, prej 250 000 000 (dyqind e pesëdhjetë milionë) lekësh, do të përballohen nga:

a) fondi rezervë i buxhetit të shtetit;

b) buxheti i Bashkisë Tiranë, respektivisht, për shoqëritë e linjave qytetëse të Tiranës.

II. KRITERET DHE DOKUMENTACIONI PËR PËRFTITIMIN E KOMPENSIMIT

1. Kërkesa për të përfituar kompensimin financiar, të përcaktuar në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi, bëhet nga subjekti çdo muaj pranë administratës tatimore, nën juridiksionin e së cilës ai është regjistruar, e cila bën verifikimin e dokumentacionit të paraqitur.

2. Subjektet kërkuese duhet të paraqesin pranë administratës tatimore, nën juridiksionin e së cilës janë regjistruar, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesën, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) Kopjen e licencës përkatëse të vlefshme për transportin qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës;

c) Të dhënat identifikuese të subjektit tatimpagues të pajisur me NIUS;

ç) Emrin e bankës, ku subjekti përfitues ka llogarinë rrjedhëse bankare;

d) IBAN-in e llogarisë bankare, jo më shumë se 28 karaktere dhe në monedhën lekë;

dh) Për shoqëritë që kryejnë vetëm aktivitet të transportit qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës, kopje të faturave fizike të furnizimit me karburant për periudhën mars, prill, maj të viteve 2025 dhe 2026;

e) Për shoqëritë, që përveç aktivitetit të transportit qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës ushtrojnë edhe aktivitete të tjera, përveç kopjeve të faturave fizike të furnizimit me karburant për periudhën mars, prill, maj të viteve 2025 e 2026, duhet të paraqesin edhe:

i. vetëdeklarim të sasisë së karburantit të përdorur për transportin qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës;

ii. kopje të fletëdaljeve të karburantit gjatë muajve mars, prill, maj të viteve 2025 e 2026, të përdorur për transportin qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës, sipas targave të mjeteve.

3. Kërkesat nga subjektet paraqiten pas datës 10 (dhjetë) të muajit pasardhës, duke filluar nga muaji prill 2026.

4. Në rastin kur konstatohet se dokumentet e dorëzuara nga subjekti janë të paplota apo kanë mangësi, administrata tatimore, brenda 5 (pesë) ditëve punë, e kthen kërkesën, me qëllim plotësimin e dokumentacionit.

5. Administrata tatimore pas verifikimit të dokumentacionit, të përcaktuar në pikën 2, të këtij kreu, dërgon pranë degës përkatëse të thesarit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve punë, urdhërshpenzimet, duke bashkëlidhur listën përmbledhëse të subjekteve përfituese, sipas bankave të nivelit të dytë, ku përfituesit kanë llogarinë e tyre bankare.

6. Kur shpenzimet përballohen nga Bashkia Tiranë, administrata tatimore, pas verifikimit të dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2, të këtij kreu, i dërgon, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë Bashkisë Tiranë, në tërësi, dokumentacionin e administruar dhe listën përmbledhëse të subjekteve përfituese dhe vlerave.

7. Bashkia Tiranë, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë, dërgon pranë degës përkatëse të thesarit urdhërshpenzimet, duke bashkëlidhur listën



përmbledhëse të subjekteve përfituese, sipas bankave të nivelit të dytë, ku përfituesit kanë llogarinë e tyre bankare.

8. Për shoqëritë e regjistruara pas muajit maj 2025, si vlerë reference për kompensim do të merret vlera më e lartë e konsumit të karburantit, për periudhën janar–shkurt 2026.

9. Me qëllim shmangien e abuzimit, strukturat e administratës tatimore mund të kryejnë edhe verifikime në vend, në rast konstatimi të pasaktësive në dokumentacionin e paraqitur në kërkesë.

10. Struktura e thesarit në degë, mbas marrjes së urdhërshpenzimit me listën e përfituesve, sipas pikës 5, të këtij kreu, kryen pagesën brenda 5 (pesë) ditëve punë.

III. ÇËSHTJE TË FUNDIT

1. Kërkesat për kompensim do të pranohen deri në datën 1 gusht 2026.

2. Efektet financiare, prej 250 000 000 (dyqind e pesëdhjetë milionë) lekësh, do të përballohen nga:

a) fondi rezervë i buxhetit të shtetit, në masën 120 000 000 (njëqind e njëzet milionë) lekë;

b) buxheti i Bashkisë Tiranë, respektivisht, për shoqëritë e linjave qytetëse të Tiranës, në masën 130 000 000 (njëqind e tridhjetë milionë) lekë.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Bashkia Tiranë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

SHTOJCA NR. 1

KËRKESË

EMRI I SUBJEKTTT: _____

NIPT: _____

Banka: _____ (vetëm për bankat aktive)

Iban (LEKË): _____ (jo më shumë se 28 karaktere)

*Bashkëlidhur kësaj kërkesë:

- kopja e licencës aktive;

- vërtetimi i lëshuar nga banka për llogarinë bankare;

- kopje të faturave fizike të furnizimit me karburant për periudhat: mars, prill, maj 2026.



VENDIM

Nr. 342, datë 13.5.2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 182, DATË 20.3.2025,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTEVE
TË SIGURISË DHE ÇMIMIT TË
PULLAVE FISKALE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 40, pika 1, e 42, të ligjit nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 182, datë 20.3.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e elementeve të sigurisë dhe çmimit të pullave fiskale”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Përcaktimin e elementeve kryesore të pullave fiskale me sistem gjurmimi, si më poshtë vijon:

A) Karakteristikat e sigurisë

Elementet e sigurisë së pullave fiskale kategorizohen, si më poshtë vijon:

a) Karakteristika të dukshme me sy të lirë:

i. sfond i sigurt që përfshin elemente grafike të tipit *guilloche* dhe tekst të imët;

ii. kod dydimensional i dukshëm (*DataMatrix*) dhe kod i lexueshëm nga njeriu (*Human Readable Code* – HRC);

iii. element optik me ndryshim ngjyre (*optically variable colour-shifting element*);

iv. strukturë rezistente ndaj ndërhyrjeve, me prerje teknike (*die-cuts*) në shtresën vetëngjithëse;

b) Karakteristika gjysmë të fshehura (*Semi-Covert Features*):

i. elemente grafike të integruara me efekte të dyfishta polarizimi;

ii. karakteristika reaktive ndaj rrezeve ultraviolette (UV), të dallueshme përmes ekspozimit ndaj dritës ultraviolette UV;

iii. elemente sigurie grafike të integruara brenda kodit 2D, të verifikueshme përmes aplikacionit zyrtar;

c) Karakteristika të fshehura (të padukshme me sy të lirë):

i. kod dydimensional i padukshëm, i zbulueshëm vetëm me pajisje të specializuara;

ii. identifikues unikë të enkriptuar, të koduar si në kodet e dukshme ashtu edhe në ato të padukshme, të menaxhuar përmes Sistemit të Gjurmueshmërisë dhe Kontrollit të *ALBTrace*;

iii. substrat që përmban fibra sigurie, të integruara në materialin bazë;

ç) Analiza të detajuara hetimore:

Elemente sigurie të nivelit të avancuar, të integruara në materialin e pullës fiskale, të cilat nuk janë të dukshme dhe nuk mund të verifikohen me mjete standarde kontrolli.

Këto karakteristika mundësojnë autentifikimin shkencor të pullës fiskale vetëm përmes analizave të specializuara të kryera në laboratorë të analizave të detajuara, duke përdorur pajisje dhe metoda teknike të dedikuara.

B) Shënjimi i drejtpërdrejtë i sigurt për birrën vendase dhe produktet e tjera të pijeve alkoolike që prodhohen në Shqipëri nga prodhues në shkallë të madhe ose të importuara nga importues të autorizuar për këtë qëllim:

a) Një kod unik dydimensional (*Datamatrix*) printohet drejtpërdrejt mbi produkt gjatë procesit të kodimit;

b) Kodi gjenerohet dhe menaxhohet përmes Sistemit të Gjurmueshmërisë dhe Kontrollit të *ALBTrace*;

c) Shënjimi projektohet në mënyrë të tillë që të jetë rezistent ndaj ndërhyrjeve dhe manipulimeve, si dhe të mundësojë verifikimin nga autoritetet kompetente;

ç) Shënjimi përmban elemente sigurie të menaxhuara elektronikisht, të barasvlershme në nivel sigurie me ato të pullave fiskale fizike.”;

b) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Zbatimi i sistemit të pullave fiskale, si version i përditësuar i sistemit ekzistues nëpërmjet shtimit të funksionaliteteve të reja dhe rritjes së nivelit të sigurisë, sipas parashikimeve të këtij vendimi, fillon në datën 1 korrik 2026.

Pullat fiskale të prodhuara dhe të vendosura në përdorim përpara datës 1 korrik 2026 mbeten të vlefshme dhe të përdorshme deri në përdorimin e plotë të tyre, por jo më vonë se data 1 korrik 2027.

Gjatë periudhës kalimtare drejt sistemit të ri të pullave fiskale, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe shoqëria aksionare shtetërore



“ALBTrace Co” sh.a. të marrin masat organizative, teknike dhe administrative.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë” sh.a., Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe shoqëria aksionare shtetërore “ALBTrace Co” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 343, datë 13.5.2026

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR
LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË,
ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA,
NDËRMJET MINISTRISË SË
EKONOMISË DHE INOVACIONIT, SI
QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË
“ALUFLOR” SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR
PASURINË SHTETËRORE NR. 10/211,
NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË
MINISTRISË SË EKONOMISË DHE
INOVACIONIT, DHE PASURINË
SHTETËRORE NR. 5/160/ND, NË
PRONËSI TË SHOQËRISË “PETROL
ALBA” SHA, NË ZONËN KADASTRALE
8516, ME VENDNDODHJE NË DURRES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 5, të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë, me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, si qiradhënës, dhe shoqërisë “ALUFLOR” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë shtetërore nr. 10/211, të llojit “truall”, me sipërfaqe të përgjithshme 30 310.89 (tridhjetë mijë e treqind e dhjetë pikë tetëdhjetë e nëntë) m², nga e cila 13 827.31 (trembëdhjetë mijë e tetëqind e njëzet e shtatë pikë tridhjetë e një) m² sipërfaqe ndërtimore, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, dhe pasurinë shtetërore nr. 5/160/ND, të llojit “ndërtesë”, me sipërfaqe 685.3 (gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë pikë tre) m², në pronësi të shoqërisë “Petrol Alba” sh.a., në likuidim, në zonën kadastrale 8516, me vendndodhje në Durrës, për 20 (njëzet) vjet, sipas kartelave të pasurive, fragmenteve të hartave kadastrale, genplaneve dhe tekstit të projektkontratës, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, shoqëria “Petrol Alba” sh.a., në likuidim, dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË

Nr. _____ rep.

Nr. _____ kol.

KONTRATË QIRAJE

Në Tiranë, sot më _____, të muajit _____, të vitit _____, (_____), u paraqitën para meje, noterit _____, palët kontraktuese, si më poshtë vijon:

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, përfaqësuar me autorizim të titullarit të institucionit “Qiradhënës”, nr. _____ nga z./znj. _____, me detyrë _____, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, i datëlindjes _____._____._____, banues në _____, me shtetësi shqiptare i/e pajisur me letër njoftimin nr.



_____, që më poshtë do të quhet
“QIRADHËNËSI”

DHE

Shoqëria “ALUFLOR” sh.p.k., me seli qendrore në _____, me adresë: _____, regjistruar si person juridik dhe pajisur nga QKB-ja, me NIPT: _____, përfaqësuar nga z./znj. _____, i/e biri/bija i/e _____, i datëlindjes _____._____, lindur në _____ dhe banues në _____, me shtetësi _____, identifikuar me letër njoftimin personal me nr. _____, që më poshtë do të quhet **“QIRAMARRËSI”**.

Institucioni “Qiradhënës”, me propozimin nr. _____, datë _____._____, të _____, mbështetur në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”, të ndryshuar, në zbatim të vendimit nr. _____, datë _____._____, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, si Qiradhënës, dhe shoqërisë “ALUFLOR” sh.p.k., si Qiramarrës, për pasurinë shtetërore nr. 10/211, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, dhe pasurinë shtetërore nr. 5/160/ND, në pronësi të shoqërisë “Petrol Alba” sh.a., në likuidim, në zonën kadastrale 8516, me vendndodhje në Durrës, për 20 (njëzet) vjet, dhe bazuar në nenet 801–825 të Kodit Civil, palët bien dakord të hartojnë këtë kontratë, me kushtet, si më poshtë:

Neni 1**Objekti i kontratës**

Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e pasurisë shtetërore nr. 10/211, e llojit “truall”, me sipërfaqe të përgjithshme 30 310.89 m², nga e cila 13,827.31 m² sipërfaqe ndërtimore, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, dhe pasurisë shtetërore nr. 5/160/ND, të llojit “ndërtesë”, me sipërfaqe 685.3 m², në pronësi të shoqërisë “Petrol Alba” sh.a., në likuidim, në zonën kadastrale 8516, me vendndodhje në Durrës, për 20 (njëzet) vjet, sipas kartelave të pasurive, fragmenteve të hartave kadastrale dhe genplaneve, bashkëlidhur kontratës.

Neni 2**Qëllimi i përdorimit**

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm i objektit, të përcaktuar në nenin 1, të kësaj kontrate, për magazinimin dhe montimin e fasadave me sisteme të ndryshme, sisteme xhami efikase energjie dhe teknologji smart, duke iu nënshtruar regjimit të përpunimit aktiv.

Neni 3**Kohëzgjatja**

Kjo kontratë është e vlefshme për 20 (njëzet) vjet dhe hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Neni 4**Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit**

4.1 “Qiradhënësi”, nëpërmjet Degës së Shoqërive Publike Elbasan dhe shoqërisë “Petrol Alba” sh.a., në likuidim, dorëzon, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, pronën e përcaktuar në nenin 1 të saj, të lirë për t’u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet procesverbali i dorëzimit të objektit që jepet me qira, i shoqëruar me foto, që është pjesë përbërëse e kontratës.

4.2 “Qiradhënësi” ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e “Qiramarrësit”.

4.3 “Qiradhënësi” ka të drejtë që, në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së kontratës, nëpërmjet njësive monitoruese të kontratës së qirasë, Dega e Shoqërive Publike Elbasan dhe shoqëria “Petrol Alba” sh.a., në likuidim, të monitorojë kontratën për verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në të.

4.4 “Qiradhënësi” është i detyruar të garantojë “Qiramarrësin” për gëzimin e qetë të sendit, objekt të kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrenë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë.

4.5 “Qiradhënësi” ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 30 ditë përpara me shkrim.

4.6 “Qiradhënësi” nuk është i detyruar të garantojë Qiramarrësin nga shqetësimet e të tretëve që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.



Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

5.1 “Qiramarrësi” ka të drejtë që, sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të, për të gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

5.2 “Qiramarrësi” ka për detyrë që të përdorë sendin, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin e parashikuar në nenin 2, në përputhje me detyrimet ligjore, që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar.

5.3 “Qiramarrësi” detyrohet që, në pasurinë e marrë me qira, të realizojë aktivitetin sipas nenit 2 të kësaj kontrate, duke investuar sipas fazave dhe vlerave të shprehura në planbiznesin e paraqitur në ministrinë përgjegjëse për ekonominë.

5.4 “Qiramarrësi” detyrohet të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë objektin e kontratës së qirasë.

5.5 “Qiramarrësi” detyrohet të përballojë me shpenzimet e tij detyrimet që lidhen me dëmet e shkaktuara eventalisht palëve të treta.

5.6 “Qiramarrësi” detyrohet të sigurojë objektin e kontratës së qirasë, nëpërmjet policës së sigurimit.

5.7 “Qiramarrësi”, në funksion të zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate, do të investojë për magazinim dhe montimin e fasadave me sisteme të ndryshme, sisteme xhami efikase energjie dhe teknologji smart, duke iu nënshtruar regjimit të përpunimit aktiv. Në kuadër të aktivitetit prodhues, shoqëria do të realizojë përpunimin dhe montimin e profileve PVC, elementeve prej alumini dhe paneleve kompozite (*Alucobond*), përmes përdorimit të teknologjisë së avancuar dhe në përputhje me standardet teknike dhe të sigurisë, duke garantuar cilësi të lartë të produkteve finale dhe duke arritur një investim **në vlerën 2 000 000 (dy milionë) euro**. Sipas planbiznesit të paraqitur në ministrinë përgjegjëse për ekonominë, ky investim i “Qiramarrësit” do të realizohet, si vijon:

Ky projekt parashikohet të ndërtohet në tri faza:

- **Faza e parë**, e cila do të zhvillohet përgjatë vitit të parë të projektit, do të fokusohet në rikondicionimin e godinave ekzistuese dhe përmirësimin e infrastrukturës mbështetëse, me një vlerë investimi prej rreth 500 000 (pesëqind mijë) euro, duke përfshirë pastrimin dhe sistemimin e terrenit, riparimin e rrethimeve, punime industriale, elektrike dhe hidraulike, instalimin e sistemeve të mbrojtjes nga zjarri dhe të sistemit HVAC, si dhe

ndërhyrje të tjera funksionale në ambientet e brendshme;

- **Faza e dytë**, e cila do të realizohet brenda vitit të dytë të projektit, parashikohet instalimi i linjave të prodhimit dhe i makinerive për përpunimin e fasadave alumini, fasadave plastike dhe elementeve të prefabrikuara, me një vlerë investimi prej rreth 600 000 (gjashtëqind mijë) euro;

- **Faza e tretë**, e cila do të zhvillohet brenda 3 vjetëve, do të fokusohet në punimet për përfundimin dhe modernizimin e objektit, duke përfshirë veshjen me panele sanduiç dhe fasadë xhami, instalimin e paneleve fotovoltaike, rrethimin perimetral, si dhe sistemimin ambiantal dhe estetik të hapësirës, duke parashikuar një vlerë investimi prej rreth 900 000 (nëntëqind mijë) euro.

Në total, në të tria fazat do të investohen 2 000 000 (dy milionë) euro, i cili do të arrihet pas 5 (pesë) vjetësh, pasi të jenë marrë lejet përkatëse.

5.8 “Qiramarrësi”, sipas parashikimit për punësimin të shprehur në planbiznesin e paraqitur detyrohet që, në objektin e marrë me qira, do të jenë të punësuar gjithsej **150 (njëqind e pesëdhjetë) punonjës** me kohë të plotë. Ky nivel punësimi do të arrihet pas 5 (pesë) vjetësh pasi të jenë marrë lejet përkatëse. Në vitin e parë të investimit, numri i të punësuarve nuk do të jetë më pak se 50 (pesëdhjetë) punonjës.

Pavarësisht parashikimeve të realizimit si më sipër, monitorimi dhe përlllogaritjet e afateve të realizimeve të punësimit të parashikuar transferohen në kohë, gjithmonë pas datës së lejeve përkatëse të nevojshme për punime, ngritjen e aktivitetit dhe vënien në jetë të tij. “Qiramarrësi” detyrohet të zbatojë legjislacionin në fuqi “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.

5.9 “Qiramarrësi”, në funksion të qëllimit sipas nenit 2 dhe zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër, sipas neneve 5.7 e 5.8, detyrohet që të pajiset me leje ndërtimi dhe leje mjedisore nga organet kompetente.

5.10 “Qiramarrësi” detyrohet që, para përfundimit të vitit të pestë të përdorimit të objektit me qira, sipas kësaj kontrate, të paraqesë para Qiradhënësit shtesën e planbiznesit për treguesit e periudhës në vijim, brenda objektit të kontratës dhe pa ulur treguesit e shprehur në pikat 5.7 e 5.8 të kësaj kontrate.



5.11 “Qiramarrësi” detyrohet të paraqesë të “Qiradhënësi”, në fillim të çdo viti, relacion me shkrim, lidhur me vlerat e investimeve, të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të subjektit, shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar, vërtetuar me çdo dokumentacion të vlefshëm, si dhe vërtetimin nga institucionet shtetërore përkatëse për numrin e të punësuarve në objektin e marrë me qira.

5.12 “Qiramarrësi” detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padëmtuar.

5.13 “Qiramarrësi”, në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa e dëmtuar atë. “Qiradhënësi” nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga “Qiramarrësi”.

5.14 Në ngarkim të “Qiramarrësit” janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

5.15 “Qiramarrësit” nuk i lejohej, që pronën e dhënë me qira ta japë me nënqira ose t’ia kalojë kontratën një tjetri.

5.16 “Qiramarrësi”, në funksion të qëllimit dhe zhvillimit të aktivitetit, sipas nenit 2, të kësaj kontrate, në territorin, objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër, sipas neneve 5.7 e 5.8, detyrohet që të pajiset me lejet ose autorizimet përkatëse nga organet kompetente të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

5.17 “Qiramarrësi” në asnjë rast nuk mund ta rëndojë me barrë pronën, objekt kontrate.

Neni 6

Pagesa e qirasë

6.1 “Qiramarrësi” detyrohet t’i paguajë “Qiradhënësit” detyrimin e kontratës, në vlerën 1 (një) euro. Pagesa simbolike bëhet para se të firmoset kontrata.

6.2 Para nënshkrimit të kontratës, “Qiramarrësi” ka paguar garancinë e kontratës në formën garanci bankare/kompani sigurimi, në vlerën 40 000 (dyzet mijë) euro, sipas faturës së lëshuar nga “Qiradhënësi”, e cila qëndron e ngurtësuar në llogarinë përkatëse në buxhetin e shtetit, deri në përfundim të investimit të shprehur në nenin 5.7 të kësaj kontrate. Garancia kthehet pas përfundimit të investimit.

6.3 Në rastet kur konstatohen parregullsi dhe zbatohen penalitete (gjyba dhe kamatëvonesë), “Qiramarrësi” do të likujdojë vlerat e krijuara në llogarinë e “Qiradhënësit”, sipas faturës së lëshuar nga ky i fundit.

Neni 7

Penalitetet

7.1 Në rastin kur “Qiramarrësi”, në përfundim të çdo faze, sipas përcaktimeve në pikën 5.7, të kësaj kontrate, nuk realizon vlerën e investimit, do të penalizohet me gjobë, në masën 10 për qind të vlerës së investimit të përcaktuar. Nëse, pas 6 muajve, investimi vazhdon të mos realizohet, “Qiradhënësi” zgjidh kontratën dhe gjobit “Qiramarrësin” me vlerën e garancisë së ngurtësuar në momentin e lidhjes së kësaj marrëveshje kontraktore.

7.2 Në rastin kur, “Qiramarrësi”, në përfundim të çdo faze, nuk ka realizuar nivelin e punësimit të përcaktuar në pikën 5.8, të kësaj kontrate, penalizohet me gjobë, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo vend pune mesatar vjetor të pahapur.

Neni 8

Zgjidhja e kontratës

8.1 Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit, të përcaktuar në pikën 3, të kësaj kontrate.

8.2 Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

- a) në marrëveshje midis palëve;
- b) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore;
- c) kur “Qiramarrësi” shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5 e 6, të kësaj kontrate;
- ç) kur “Qiramarrësi” shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5.7, të kësaj kontrate;
- d) kur prona nevojitet për interes publik;
- dh) kur prona kalon në procedurë privatizimi.

8.3 Kontrata pushon automatikisht së vepruari 30 ditë pas njoftimit me shkrim të “Qiradhënësit” për zgjidhjen e kontratës para afatit, sipas pikës 8.2 të saj dhe nëse “Qiramarrësi” nuk ka reaguar me shkrim.

Neni 9

Përgjegjësitë e palëve

9.1 Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.

9.2 Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në



fuqi, në përfundim të investimit, pas relacionit të paraqitur nga “Qiramarrësi”, sipas pikave 5.7 dhe 5.8, të kësaj kontrate, palët janë të detyruara të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta ndërmjet njërive administruese të pasurive, Degës së Shoqërive Publike Elbasan dhe shoqërisë “Petrol Alba” sh.a., në likuidim, për nivelin e investimeve dhe punësimit të realizuar, sipas vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare të subjektit, shoqëruar me relacionin përkatës, të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar.

9.3 Palët, “Qiramarrësi” dhe “Institucioni administrues dhe monitorues i kontratës së qirasë”, Dega e Shoqërive Publike Elbasan, shoqëria “Petrol Alba” sh.a., janë të detyruara që çdo vit të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta për realizimin e kushteve të kontratës, në nivelin e punësimit, në nivelin e investimit dhe shlyerjen e penalteteve ose gjobave (në rastet kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate.

9.4 Me “forcë madhore” do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si: tërmetet, përmbytjet, lufta. Në këto raste, palët janë të detyruara të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjatet për aq kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.

9.5 “Qiramarrësi” përjashtohet nga detyrimet për kohën e vazhdimit të forcës madhore dhe moskryerjes së aktivitetit për këtë shkak. Kjo periudhë do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve.

Neni 10

Dispozita të fundit

10.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do t’u referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

10.2. Pjesë të kësaj kontrate janë dokumentacioni kadastral, planbiznesi i paraqitur në ministrinë përgjegjëse për ekonominë dhe procesverbali i marrjes në dorëzimi të objektit, sipas kontratës së qirasë.

10.3. Mosmarrëveshjet, që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate, do të zgjidhen me mirëkuptim dhe, në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t’i drejtohen Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

10.4. Në çdo rast të kalimit të mosmarrëveshjeve, të lindura mes palëve në juridiksion gjyqësor, autorizohet njësi administruese dhe monitoruese e kontratës për ndjekjen e procedurës gjyqësore.

10.5. Kjo kontratë qiraje është e vlefshme deri në çastin që prona publike e dhënë me qira privatizohet, sipas akteve ligjore në fuqi.

Neni 11

Brenda një muaji nga nënshkrimi i saj, kontrata duhet të regjistrohet në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Shpenzimet noteriale të kësaj kontrate i ngarkohen “Qiramarrësit”.

Kjo kontratë është formuluar në 7 (shtatë) kopje origjinale. Pasi iu lexua palëve, u kuptua, u pranua prej tyre, si dhe u nënshkrua para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë. Ndërsa, unë noter _____, në bazë të nenit 801 e në vijim të Kodit Civil, e vërtetoj atë si të rregullt.

QIRADHËNËSI
Ministria e Ekonomisë
dhe Inovacionit

QIRAMARRËSI
Shoqëria “ALUFLOR”
sh.p.k.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 8516013185
(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 8516, Lloji i Pasurisë: TRUALL, Nr. i Pasurisë: 10/211, Sipërfaqja Totale 30310.89m²,
(Nga të Cilat Truall 30310.89m²; Ndërtesë 13827.31m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale DR;I-12, Numri i Pemëve: 0,

Adresa e Pasurisë: Bashkia DURRES, Rruga SHKOZET/14, Ndërtesa Nr. 086, SH/K 1, Apartamenti Nr. 1

Vlera e Pasurisë:

Fillestare 1 Leke (Akti Nr. 1, Dt. 08/10/2011), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: Republika e Shqipërisë, Nr. Identifikimi/NIPT R00000000SH, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia _____, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Akteve të tjera sipas legjislacionit në fuqi, Nr. 1, Datë: 08/10/2011

Regjistruar: Nr. LN.2010, Datë: 08/10/2011

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfutues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT
9323	11/05/2026	Administrim	VKM për të drejtën e administrimit/përdorimit	314	06/05/2026	99 vite	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit	M52126454J

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfutues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: _____, Emërtimi i Aktit: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi: MBI KETE PASURI NDODHEN 3 NDERTIME ME SIPERFAQE TOTALE PREJ 13827,31 m2, EVIDENTUAR SIPAS PLANIT TE RILEVIMIT TE DEPOZITUAR ME APLIKIMIN NR.8860, DATE 03.02.2026 NGA MINISTRIA E EKONOMISE DHE INOVACIONIT, (NDERTESA ND1 ME SIP. 9212,27 m2, NDERTESA ND2 ME SIP. 4085,91 m2, NDERTESA ND3 ME SIP. 529,13 m2)

DREJTORI
Elvis PengiliBesmir
AhmetiDigitally signed by:
Besmir Ahmeti
Date: 2026.05.11
06:12:57 +02'00'Elvis
PengiliDigitally signed by:
Elvis Pengili
Date: 2026.05.11
06:43:39 +02'00'

Data e lëshimit 11/05/2026


Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore DURRËS-KAVAJË-KRUJË
Date: 2026/05/11 18:15:58 +02'00'
M52126454J2026051118155125ASHKShënim : Ky dokument është generuar dhe vuloar me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE: **8516**KODI UNIK: **8516013185**NUMRI PASURISË: **10/211**INDEKSI HARTËS: **DR;I-12**

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 2500

DREJTORI

Elvis Pengili

Digitally signed by:
Migena Nalibani
Date: 2026.05.11
05:48:55 +02'00'

Nalibani

Digitally signed by:
Besmir Ahmeti
Date: 2026.05.11
06:12:20 +02'00'

Ahmeti

Digitally signed by:
Elvis Pengili
Date: 2026.05.11
06:43:21 +02'00'

Pengili

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore DURRES-KAVAJE-KRUJE
Date: 2026/05/11 17:49:45 +02'00'
M52126454J20260511174934974014Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

SHPJEGUES

- PARCELA
- NDËRTESTA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS**

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 8516010139
(Nga _____, Në 8516008044)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 8516 , Lloji i Pasurisë: NDERTESE , Nr. i Pasurisë: 5/160/ND , Sipërfaqja Totale 685.3 m²,
(Nga të Cilat Truall 0 m²; Ndërtesë 685.3 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale DR;J-11 , Numri i Pemëve: 0 ,

Adresa e Pasurisë: Bashkia DURRËS , Rruga ADRIA 00690024 , Ndërtesa Nr. 7 , SH/K 26 , Apartamenti Nr. ____

Vlera e Pasurisë:

Fillestare 1 Leke (Akti Nr. 21 , Dt. 06/01/2022), Rivlerësim ____ (Akti Nr. ____ , Dt. ____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: PETROL ALBA , Nr. Identifikimi/NIPT K81706017T , Pjesa Takuese 1/1 , Lloji i Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia _____ , Rruga _____ , Ndërtesa Nr. _____ , SH/K _____ , Apartamenti Nr. _____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Akteve të tjera sipas legjislacionit në fuqi , Nr. 21 , Datë: 06/01/2022

Regjistruar: Nr. 8198 , Datë: 24/08/2022

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____ , me Kod Unik _____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraparak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____ , Nr. _____ , Datë: _____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. _____ , Datë: _____





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Registrimi	Dt. Registrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT
00002590	21/09/2010		OB.BIE PJESERISHT MBITRUALIN ME NR PAS.5/158, PASURIE CILA KRJON MBIMENDOSJE ME PAS. E FAMILJES HIDRI			0		
00003496	29/10/2013		REGJISTROHE T VENDIMI I GJYKATES SE APELIT TE RRETHIT DURRES NR.395/79 DT.14.05.2013 NR.395/10-2013 -791 DT.14.05.2013			0		
00006333	30/05/2016		REGJISTROHE T VENDIMI I GJYKATES SE LARTE NR.3928 DT.26.11.2015 MBETET NE FUQI PIKA 2 DHE 3 I VENDIMIT TE APELIT.			0		

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Registrimi	Dt. Registrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkuës	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: _____, Emërtimi i Aktit: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi: 2112 ME REF.7329 NDODHET DEKLARATA PER PRANIMIN E 685,30 M2





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

DREJTORI
Elvis Pengili



Besmir
Ahmeti

Digitally signed by:
Besmir Ahmeti
Date: 2026.02.13
01:50:11 +02'00'

Armand
Mehmet

Digitally signed by:
Armand Mehmet
Date: 2026.02.13
03:06:23 +02'00'

Elvis
Pengili

Digitally signed by:
Elvis Pengili
Date: 2026.02.13
08:34:19 +02'00'

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore DURRES-KAVAJE-KRUJE
Date: 2026/02/13 13:51:56 +02'00'
KB1706017T2026021313514915ASHK

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadasrës)





REPUBLICA E SHQIPERISE

AGJENCIA SHTETERORE E KADASTRES

FRAGMENTI I HARTES KADASTRALE

ZONA KADASTRALE:8516

KODI UNIK:8516010139

NUMRI I PASURISE:5/160/ND

INDEKSI HARTES:(DR-J-11)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

N

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore DURRËS-KAVAJË-KRUJË).



GENPLAN					
POROSITES: PETROL ALBA SH.A.			DATE: 26/01/2026		QELIMI: QIRAMARRJE
VENDNDODHJA BASHKIA DURRES DVASHK/ZVASHK DURRES ZONA KADASTRALE 8516 NUMRI I PASURISE : 5/160/ND INDEX HARTE: DR-J-11					
TE DHENAT E PASURISE LLOJI PASURISE: NDERTESE SIPERFAQE GJURMES SE NDERTIMIT: 685.3 m2 NUMRI KATEVE: 3K					
x: 456477.105 y: 4576066.761			KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE		x: 456572.157 y: 4576066.761
SH 1: 1000 SHpjegues Pasuria 5/160/ND-Ndertese=685.3m2					
x: 456477.105 y: 4575999.411			SH 1: 1000		x: 456572.157 y: 4575999.411
Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT
1					
2					
3					
4					
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT Ing. Ferdinand Tola Licenca T.0245/3, Data 22.01.2018 Person fizik. NIPT: L4228266020 Nenshkrimi/Vula: PETROL ALBA SH.A. Administrator: Nenshkrimi/Vula: TEKNOLOGJIA E MATJEVE: Z Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren, Z-Zyre, O-Ortofoto, G-GPS, S-Station Total, D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFIRIT: HK Kode per percaktimin e kufirit: P-Perfaqesues i Pronareve, K-Kufitare te Gjitha, KP-Kufitare Pjesensht, PB-Perfaqesues Bashkie, HK-Harta Kadastrale SHENIME TE VEÇANTA Ne fragmentin e hartës kadastrale të paraqitur më sipër janë evidentuar pasuritë e mëposhtme: Pasuria nr. 5/160/ND – Ndërtesë, me sipërfaqe 685.3 m²					
Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi i kufirit: T-Terren, Z-Zyre, O-Ortofoto, G-GPS, S-Station Total, D-Matje Distancash, P-Perfaqesues i Pronareve, K-Kufitare te Gjitha, KP-Kufitare Pjesensht, PB-Perfaqesues Bashkie, HK-Harta Kadastrale					



VENDIM

Nr. 344, datë 13.5.2026

**PËR NGARKIMIN E FONDIT SHQIPTAR
TË ZHVILLIMIT, SI AUTORITET
KONTRAKTOR, PËR REALIZIMIN E
FAZËS PARAPRAKE TË PROJEKTIT
“PARKU I BESIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si autoritet kontraktor dhe njësi zbatuese për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, për realizimin e fazës paraprake të projektit “Parku i Besimit”, si dhe përfshirjen e këtij projekti në programin e tij zhvillimor.

2. Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në cilësinë e autoritetit kontraktor dhe njësisë zbatuese, sipas pikës 1, ngarkohet të kryejë:

- a) projektimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve utilitare;
- b) trajtimin e aksesit drejt dhe brenda Parkut;
- c) trajtimin e hapësirave të parkimit;
- d) ndërtimin e infrastrukturës nëntokësore;
- d) ndërhyrjet që lidhen me sigurinë, përfshirë rrethimin.

3. Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Korporata e Investimeve Shqiptare dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit lidhin marrëveshje bashkëpunimi, në funksion të zhvillimit të projektit, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Korporata e Investimeve Shqiptare, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM

Nr. 345, datë 13.5.2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 646, DATË 22.7.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE E TË
KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES SË
ZHVILLUESIT NË ZONËN E
TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT
EKONOMIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 646, datë 22.7.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 3, të nenit 14, togfjalëshi “... dhe zhvilluesit të saj ...” hiqet.

2. Në pikën 5, të nenit 14/1, togfjalëshi “... dhe zhvilluesit të saj ...” hiqet.

3. Paragrafi i parë, i nenit 18, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Institucioni përgjegjës, në rastet kur përzgjedhja e zhvilluesit bëhet sipas parashikimeve të pikës 1 të nenit 4 të këtij vendimi, fton kandidatin/ofertuesin e shpallur fitues të nisë procedurat e negocimit të kontratës menjëherë pas publikimit të njoftimit të fituesit. Në rastet kur përzgjedhja e zhvilluesit realizohet sipas parashikimeve të pikave 2, 3 dhe 4, të nenit 4, institucioni përgjegjës fton kandidatin për të filluar procedurat e negocimit të kontratës pas njoftimit përkatës. Procedurat e negocimit përfundojnë brenda një afati jo më të gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë nga data e publikimit.”.

4. Në pikën 3, të nenit 19, fjalët “... dhe i konfirmuar nga bashkia nën juridiksionin e së cilës është territori që do të shpallet zona ...” hiqen.

5. Neni 20 ndryshohet, si më poshtë vijon:



“Neni 20

Miratimi i kontratës

Miratimi i kontratës kryhet nga ministri përgjegjës për ekonominë, pas përfundimit të negocimit dhe vetëm pasi të jenë marrë paraprakisht mendimet nga Avokatura e Shtetit dhe çdo institucion i përfshirë në zbatimin e saj.”

6. Pas nenit 20 shtohet neni 20/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 20/1

Vënia në dispozicion të zhvilluesit të pasurive të paluajtshme shtetërore

1. Pasuritë e paluajtshme shtetërore, që përdoren për krijimin e zonës teknologjike të zhvillimit ekonomik, merren në përdorim nga zhvilluesi me kontratë qiraje. Elementet e kontratës së qirasë janë të përcaktuara në formatin “tip”, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Miratimi i kontratës, sipas pikës 1, të këtij neni, kryhet nga ministri përgjegjës për ekonominë, pasi të jetë marrë paraprakisht informacioni nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në përputhje me ligjin nr. 111/2018, “Për kadastrën”, për statusin aktual të pasurisë, për sipërfaqen në të cilën do të ndërtohet zona teknologjike e zhvillimit ekonomik, shoqëruar me kopje të aktit përkatës kadastral dhe të mendimit të shprehur nga organi shtetëror që administron pasuritë e paluajtshme.”

II. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI 1

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË**

Nr. _____ Rep.

Nr. _____ Kol.

KONTRATË QIRAJE (TIP)

Në Tiranë, sot më _____, të muajit _____, të vitit _____ (_____), u paraqitën para meje, noterit _____, palët kontraktuese, si më poshtë vijon:

Institucioni “Qiradhënës”, përfaqësuar me autorizim të titullarit të institucionit “Qiradhënës”, nr. _____ nga z./znj. _____, me detyrë _____, në (institucionin “Qiradhënës”), i datëlindjes _____, banues në _____ me shtetësi shqiptare i/e pajisur me letër njoftimin nr. _____, që më poshtë do të quhet “QIRADHËNËSI”,

Dhe

Subjekti “_____”, me seli qendrore në _____ me adresë: _____, regjistruar si person fizik/juridik dhe pajisur nga QKB-ja, me NIPT: _____, përfaqësuar nga z./znj. _____, i biri/bija i/e _____, i datëlindjes _____, lindur në _____ dhe banues në _____, identifikuar me letërnjoftimin personal me nr. _____, që më poshtë do të quhet “QIRAMARRËSI”.

Institucioni “Qiradhënës”, mbështetur në ligjin nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, i ndryshuar, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave _____, datë _____, “_____”, kontratën “Për ndërtimin, administrimin dhe monitorimin e funksionimit të zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” me nr. _____ rep., nr. _____ kol., të nënshkruar në datën _____, ndërmjet institucionit përgjegjës dhe subjektit _____, bazuar në nenet 801–825 të Kodit Civil, palët bien dakord të hartojnë këtë kontratë, me kushtet, si më poshtë:



Neni 1

Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është dhënia kontratë qiraje 1 euro e pasurive shtetërore: “_____”, sipas genplanit dhe dokumenteve të ASHK-së _____, bashkëlidhur kontratës.

Neni 2

Qëllimi i përdorimit

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm i pasurive të përcaktuara në nenin 1, për ndërtimin dhe funksionimin e Zonës së Teknologjisë së Zhvillimit Ekonomik.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kjo kontratë është e vlefshme për _____ vjet dhe hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit

4.1. “Qiradhënësi” dorëzon, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, pasuritë shtetërore, përcaktuar në nenin 1 të saj, të lira për t’u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet procesverbali i dorëzimit të pasurive që jepen me qira, i shoqëruar me foto, i cili është pjesë përbërëse e kontratës.

4.2. “Qiradhënësi” ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e “Qiramarrësit”.

4.3. “Qiradhënësi” ka të drejtë që, në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së kontratës, të monitorojë kontratën për verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në të.

4.4. “Qiradhënësi” është i detyruar të garantojë “Qiramarrësin” për gëzimin e qetë të pasurive, objekt të kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrenë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë.

4.5. “Qiradhënësi” ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur “Qiramarrësi” shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 30 ditë përpara me shkrim.

4.6. “Qiradhënësi” nuk është i detyruar të garantojë “Qiramarrësin” nga shqetësimet e të

tretëve që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

5.1. “Qiramarrësi” ka të drejtë që, sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pasuritë e marra me qira dhe përmirësimet e bëra në të për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

5.2. “Qiramarrësi” ka për detyrë që të përdorë pasuritë, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin e parashikuar në nenin 2, në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar.

5.3. “Qiramarrësi” detyrohet që në pasurinë e marrë me qira të realizojë aktivitetin sipas nenit 2, të kësaj kontrate.

5.4. “Qiramarrësi” detyrohet të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë pasuritë shtetërore, objekt të kontratës së qirasë.

5.5. “Qiramarrësi” detyrohet të përballojë me shpenzimet e tij detyrimet që lidhen me dëmet e shkaktuara eventualisht palëve të treta.

5.6. “Qiramarrësi” detyrohet të sigurojë objektin e kontratës së qirasë, nëpërmjet policës së sigurimit.

5.7. “Qiramarrësi”, në funksion të qëllimit sipas nenit 2 dhe zhvillimit të aktivitetit, në territorin, objekt i kësaj kontrate, detyrohet që të pajiset me leje ndërtimi dhe leje mjedisore nga organet kompetente.

5.8. “Qiramarrësi” detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padëmtuar.

5.9. “Qiramarrësi”, në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa e dëmtuar atë. “Qiradhënësi” nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga “Qiramarrësi”.

5.10. Në ngarkim të “Qiramarrësit” janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

5.11. “Qiramarrësi” pronën e marrë me qira ta japë me nënqira te përdoruesi.

5.12. “Qiramarrësi”, në asnjë rast nuk mund ta rëndojë me barrë pronën, objekt kontrate.

Neni 6

Zgjidhja e kontratës

6.1. Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në nenin 3 të kësaj kontrate.



6.2. Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

- a) në marrëveshje midis palëve;
- b) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore;
- c) kur prona nevojitet për interes publik.

6.3. Kontrata pushon automatikisht së vepruari 30 ditë pas njoftimit me shkrim të “Qiradhënësit” për zgjidhjen e kontratës para afatit, sipas pikës 6.2 të saj dhe nëse “Qiramarrësi” nuk ka reaguar me shkrim.

Neni 10

Dispozita të fundit

10.1. Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do t’u referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

10.2. Pjesë të kësaj kontrate janë genplani, dokumentacioni i pronësisë dhe procesverbali i marrjes në dorëzim të objektit, sipas kontratës së qirasë.

10.3. Mosmarrëveshjet, që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate, do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t’i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor në juridiksionin ku ndodhet parku.

10.4. Në çdo rast të kalimit në juridiksion gjyqësor të mosmarrëveshjeve të lindura mes palëve, autorizohet njësia administruese dhe monitoruese e kontratës për ndjekjen e procedurës gjyqësore.

Neni 11

Brenda një muaji nga nënshkrimi i saj, kontrata duhet të regjistrohet në ASHK-në vendore.

Shpenzimet noteriale të kësaj kontrate i ngarkohen “Qiramarrësit”.

Kjo kontratë është formuluar në shtatë kopje origjinale. Pasi iu lexua palëve, u kuptua, u pranua prej tyre, si dhe u nënshkrua para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë. Ndërsa, unë noter _____, në bazë të nenit 801 e në vijim të Kodit Civil, e vërtetoj atë si të rregullt.

QIRADHËNËSI

QIRAMARRËSI

VENDIM

Nr. 346, datë 13.5.2026

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 649, DATË 16.10.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES ‘PËR KUSHTET DHE KRITERET E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË STACIONIT TË PLAZHIT’”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 64, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në rregulloren bashkëlidhur vendimit nr. 649, datë 16.10.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 5, të nenit 14, shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1. Përfshijmë, për vitin 2026, afati kohor për lidhjen e kontratave të qirasë për përdorimin e stacionit të plazheve, të parashikuar në pikën 5, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, do të jetë brenda muajit qershor.”;

b) Në nenin 5 të shtojcës I, “Kontrata model për përdorimin e hapësirës së plazhit”, që i bashkëlidhet rregullores, shtohen pikat 3 dhe 4, me këtë përmbajtje:

“3. Dhënësi, në bashkëpunim me njësinë e vetëqeverisjes vendore, mund të propozojë amendime në këtë kontratë, në rastet e ndryshimeve në kapacitetin e strukturës akomoduese, zonës së plazhit apo zhvillimeve në zonën bregujore, vetëm me pëlqimin e ndërsjellë të palëve.

4. Për kontratat ekzistuese të lidhura për përdorimin e hapësirës së plazhit, ndryshimet e parashikuara në pikën 3, të këtij neni, kryhen vetëm me pëlqimin e ndërsjellë të palëve, nëpërmjet nënshkrimit të amendimit të kontratës.”.

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për turizmin, Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 347, datë 13.5.2026

**PËR MIRATIMIN E REKOMANDIMEVE
PRIORITARE NË LUFTËN KUNDËR
KRIMINALITETIT PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 103, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 32, të nenit 6, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2026, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet ministri i Drejtësisë të përcjellë menjëherë rekomandimet prioritare pranë Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe t’ua bëjë ato të njohura drejtuesve të prokurorive të të gjitha shkallëve dhe drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, në një mbledhje të përbashkët, jo më vonë se 1 (një) muaj nga data e miratimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet ministri i Drejtësisë të ndjekë në vazhdimësi mënyrën e zbatimit të këtyre rekomandimeve, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**REKOMANDIME PRIORITARE
NË LUFTËN KUNDËR
KRIMINALITETIT PËR VITIN 2026
TIRANË, PRILL 2026**

1. HYRJA

Në mbështetje të nenit 103 të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, janë përgatitur Rekomandimet Prioritare të Këshillit të Ministrave për Prokurorin e Përgjithshëm, në funksion të forcimit të luftës kundër kriminalitetit për vitin 2026. Këto rekomandime pasqyrojnë angazhimin e vazhdueshëm institucional për konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe përmirësimin e performancës së sistemit të drejtësisë penale.

Pavarësia dhe funksionaliteti i sistemit të drejtësisë kanë qenë ndër prioritetet kryesore të reformës në drejtësi, e cila ka prodhuar transformime të rëndësishme gjatë viteve të fundit. Këto përfshijnë rikonfigurimin e strukturave gjyqësore dhe të prokurorisë, fuqizimin e institucioneve të reja të pavarura, ngritjen e standardeve profesionale për emërimin dhe promovimin e magistratëve, si dhe zgjerimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale. Adresimi i dobësive të evidentuara ndër vite ka qenë një proces i vazhdueshëm, që kërkon vëmendje dhe angazhim të qëndrueshëm.

Prokuroria mbetet një institucion kyç në garantimin e rendit juridik dhe mbrojtjes së interesit publik. Rritja e efektivitetit dhe integritetit të saj është thelbësore për zhvillimin e proceseve të drejta, transparente dhe të besueshme. Në ushtrimin e funksioneve të saj, prokuroria ka detyrimin të hetojë në mënyrë të paanshme dhe të ndjekë penalisht çdo veprimtari kriminale, duke siguruar zbatimin e ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të të gjitha palëve viktimave, të akuzuarve dhe dëshmitarëve. Në këtë kuadër, vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet edhe luftës kundër evazionit fiskal, si një prioritet në mbrojtje të interesit financiar të shtetit, forcimit të rendit ekonomik dhe garantimit të konkurrencës së ndershme në treg.

Përmes forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve institucionale dhe profesionale, prokuroria rrit aftësinë për të trajtuar me efikasitet çështje të ndërlikuara dhe me ndjeshmëri të lartë shoqërore. Kjo qasje kontribuon drejtpërdrejt në garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të individëve, duke



siguruar një proces të drejtë dhe të balancuar për të gjitha palët dhe duke forcuar besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

Në mbështetje të kuadrit ligjor në fuqi dhe në vijim të një praktike të konsoliduar prej rreth 20 vjetësh, Ministria e Drejtësisë ka mbështetur vazhdimisht veprimtarinë dhe organizimin e organit të prokurorisë. Miratimi i metodologjisë për vlerësimin e zbatimit të Rekomandimeve Prioritare përbën një hap cilësor në këtë bashkëpunim institucional, duke institucionalizuar një kulturë vlerësimi të bazuar në të dhëna, transparencë dhe llogaridhënie në shërbim të drejtësisë dhe shtetit të së drejtës.

Rekomandimet Prioritare janë strukturuar në 8 fusha kryesore, si më poshtë vijon:

1. Sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut në qendër të punës së prokurorisë;

2. Forcimi i luftës kundër kriminalitetit;

3. Integriteti, përgjegjshmëria dhe transparenca e veprimtarisë së prokurorëve dhe zyrave të prokurorisë;

4. Sigurimi i eficiencës dhe ngritja e kapaciteteve institucionale;

5. Përdorimi i metodave bashkëkohore të hetimit;

6. Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë;

7. Bashkëpunimi ndërinstitucional;

8. Bashkëpunimi ndërkombëtar.

Në këtë kuadër, rekomandimet për vitin 2026, në luftën kundër kriminalitetit janë të mbështetura në një gamë dokumentesh strategjike, si dhe në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë funksionimin e secilës hallkë të sistemit të drejtësisë. Këto dokumente synojnë koordinimin dhe bashkërendimin e masave për të arritur rezultate konkrete që të ndihen si përmirësime të prekshme për sistemin, por edhe për qytetarët.

Po kështu, Ministria e Drejtësisë ka vazhduar të ndjekë zbatimin e rekomandimeve të vitit 2025, duke i analizuar dhe vlerësuar ato, ndërkohë që problematikat e dala nga ky proces kanë shërbyer si bazë për hartimin e rekomandimeve konkrete, për vitin 2026.

2. METODOLOGJIA PËR HARTIMIN E REKOMANDIMEVE

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e Rekomandimeve Prioritare 2026 u mbështet në pesë shtylla themelore, duke siguruar një qasje të strukturuar, të arsyetuar dhe të zbatueshme.

1. Analiza juridike dhe institucionale: Procesi nisi me një analizë të thelluar të kuadrit ligjor në fuqi – Kushtetutës, Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale dhe ligjeve për funksionimin e prokurorisë – duke identifikuar problematikat konkrete në zbatimin e normës ligjore.

2. Mbështetja në burime të shumëfishta dhe evidencë të matshme: Rekomandimet u bazuan në të dhëna statistikore të dërguara nga Prokuroria e Përgjithshme dhe SPAK-u, duke përfshirë tregues, si numri i procedimeve të reja, hetimet e përfunduara, masat e sigurimit dhe dërgimet për gjykim, si dhe në raportet e BE-së, SHBA-së, GRECO-s dhe MONEYVAL-it.

3. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe shkëmbimi i informacionit: Prokuroria e Përgjithshme, SPAK-u dhe ministrinë e linjës kontribuan me të dhëna dhe rekomandime, duke bërë procesin e hartimit gjithëpërfshirës dhe të bazuar në realitetin institucional.

4. Qasje me fokus në të drejtat e njeriut dhe efikasitetin institucional: Çdo rekomandim u konceptua duke vendosur në qendër respektimin e të drejtave themelore dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës, duke synuar forcimin e luftës kundër kriminalitetit, rritjen e integritetit dhe transparencës, si dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale.

5. Struktura e formulimit të rekomandimeve: Rekomandimet janë hartuar në 8 fusha kryesore, të zbërthyera në nënkomponentë, për të siguruar që ato të jenë të zbatueshme, të monitorueshme dhe të vlerësueshme.

3. METODOLOGJIA PËR MËNYRËN E VLERËSIMIT DHE TË NDJEKJES NË VAZHDIMËSI TË ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE PRIORITARE NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT

Metodologjia për mënyrën e vlerësimit dhe ndjekjes së zbatimit të Rekomandimeve Prioritare në luftën kundër kriminalitetit është miratuar me urdhrin nr. 20, datë 19.1.2026, të ministrit të Drejtësisë. Miratimi i kësaj metodologjie përbën një avancim thelbësor në kontekstin e reformave ligjore dhe institucionale, duke prezantuar standarde të qarta, objektive dhe të matshme, të bazuara në kuadrin ligjor kombëtar dhe praktikën më të mira ndërkombëtare. Kjo krijon një bazë të fortë për të siguruar që reformat jo vetëm të hartohen, por edhe të ekzekutohen me integritet dhe transparencë.



Fokusi i kësaj metodologjie është orientimi i institucioneve përkatëse me theks të veçantë institucionit të sistemit të prokurorisë për të mbledhur të dhëna të plota, të krahasueshme dhe të përdorshme për vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve. Të dhënat janë strukturuar sipas fushave kryesore të rekomandimeve dhe në mënyrë specifike për secilën prej tyre, duke mundësuar një vlerësim të saktë dhe të bazuar në evidencë të progresit institucional.

Zbatimi i kësaj metodologjie mundëson që Ministria e Drejtësisë dhe organet e tjera përkatëse të angazhohen në dialog të informuar, të nxisin bashkëpunimin ndërinstitucional dhe të sigurojnë raportim transparent ndaj qytetarëve dhe partnerëve ndërkombëtarë. Në thelb, ajo institucionalizon një kulturë vlerësimi të vazhdueshëm dhe të bazuar në të dhëna, e domosdoshme për konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe besueshmërinë e reformave në sektorin e drejtësisë.

4. DOKUMENTET DHE LEGJISLACIONI I PËRDORUR PËR HARTIMIN E REKOMANDIMEVE.

4.1 Raportet

- Komisioni i BE-së, raporti i Shqipërisë 2025, Bruksel, 4.11.2025, SWD (2025) 750 përfundimtar;
- Komisioni i BE-së 2025, raporti i sundimit të ligjit: kapitulli i shtetit mbi situatën e shtetit të së drejtës në Shqipëri, Bruksel, 8.7.2025, SWD (2025) 928 përfundimtar;
- Programi i qeverisë 2026–2030;
- Raporti i shqyrtimit të Shqipërisë 2024, *Cluster* 6, Bazat;
- Komisioni Evropian, raport i Shqipërisë për 2025-n, Bruksel, 4.11.2025 SWD (2025) 750 përfundimtar;
- Zbatimi i Konventës kundër Ryshfetit të OECD, faza 4 e ndjekjes së raportit 2-vjeçar: Itali 2024;
- Raportet e shteteve për mbi praktikën e të drejtave të njeriut, 2024: Shqipëri, Departamenti i Shtetit i SHBA-së;
- Performanca e institucioneve të posaçme dhe konsolidimi i luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (2024) – Perspektivat për të ardhmen në kontekstin e negociatave për integrimin në BE. Raporti i pestë i vlerësimit, Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG);
- Projekti Drejtësia Botërore 2025;
- Projekti Drejtësia Botërore 2024;

- Gjetjet e ekspertit nëpërmjet raportit për hartimin e rekomandimeve prioritare, për vitin 2025–2026, mbi luftën kundër krimit dhe metodologjia për vlerësimin, dhe monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të rekomandimeve prioritare, bazuar mbi kritere të përcaktuara qartë dhe të matshme.

4.2 Rekomandimet dhe politikat

- Rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave 2025;
- Rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave 2024;
- Urdhri nr. 818, datë 3.9.2024, për miratimin e dokumentit “Plani strategjik 2024–2027 për Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”.

4.3 Legjislacioni i Shqipërisë

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, i ndryshuar;
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë;
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për luftën ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, i ndryshuar;
- Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024–2030 dhe plani i saj i veprimit;
- Plani i veprimit 2024–2026, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024–2030;
- Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026–2030;
- Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitur dhe plani i veprimit 2022–2026.

4.4 Rezoluta

- Vendim i Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2023, datë 25.7.2024.



- Rezolutë e Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2024, datë 30.10.2025.

- Rezolutë e Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për vitin 2024, datë 30.10.2025.

- Vendim i Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2022, datë 6.7.2023.

4.5 Legjislacioni dhe politikat e huaja

- Ligji i Mbretërisë së Bashkuar për të Ardhurat nga Krimi 2002;

- Akti i Ryshfetit të MB-së 2010;

- Akti i Drejtësisë Penale 1987;

- Ligji për Praktikën e Huaja Korruptive të SHBA-së;

- Zyra e Brendshme e Mbretërisë së Bashkuar dhe Ministria e Drejtësisë, shkëmbimi i të dhënave për udhëzimet e sistemit të Drejtësisë Penale, tetor 2023;

- Shërbimi i Prokurorisë së Kurorës, Zyra e Pavarur e Udhëzuesit të Prokurorisë për Sjelljen e Policisë;

- Mbrojtja për sinjalizuesit: kuadri ligjor dhe i politikave për mbrojtjen e personave që raportojnë shkelje të ligjit të unionit.

4.6 Traktate dhe udhëzime ndërkombëtare

- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut 1950;

- Konventa Evropiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale 1959;

- Rregullorja e Punës së Komisionit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara – shtojca;

- Udhëzime për kornizat e pavarura të monitorimit dhe pjesëmarrjen e tyre në punën e Komisioni për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, 10 tetor 2016, CRPD/C/1/Rev. 1;

- Treguesit e të drejtave të njeriut: një udhëzues për matjen dhe zbatimin, Nju-Jork dhe Gjenevë, 2012;

- Rekomandim për punën sistematike për zbatimin e të drejtave të njeriut në nivel kombëtar, Strasburg, 18 shkurt 2009, Comm DH (2009).

REKOMANDIMET PRIORITARE PËR VITIN 2026

5. FUSHAT KRYESORE TË REKOMANDIMEVE

5.1 Sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut në qendër të punës së prokurorisë

5.1.1 Pavarësisht uljes së numrit të masave të sigurimit shtrëngues nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokuroria e Përgjithshme, si dhe analizës pesëvjeçare në proces nga Prokuroria e Përgjithshme, rekomandohet që prokuroria të sigurojë që çdo kërkesë për masë sigurie të jetë e qartë, e argumentuar dhe proporcionale me rrethanat konkrete të çështjes, duke rezervuar arrestin në burg si masë të fundit, në përputhje me parimin e prezumimit të pafajësisë dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së.

5.1.2 Rekomandohet finalizimi dhe miratimi i udhëzimit mbi afatet hetimore, duke forcuar mekanizmat e brendshëm të monitorimit dhe kontrollit të ecurisë së çështjeve, me qëllim shmangien e çdo vonese të pajustificuar që cenon të drejtën për gjykim brenda afatit të arsyeshëm.

5.1.3 Rekomandohet forcimi i zbatimit efektiv të së drejtës për konsultim konfidencial me mbrojtësin dhe prezencës së tij gjatë veprimeve procedurale, si dhe vënja menjëherë në dispozicion e letrës së të drejtave, duke siguruar unifikim praktike në të gjitha prokuroritë.

5.1.4 Rekomandohet zgjerimi i zbatimit të masave alternative dhe të drejtësisë restauruese, duke standardizuar udhëzimet e brendshme dhe rritjen e numrit të trajnimeve të posaçme, me qëllim unifikimin e praktikës dhe garantimin e parimit të proporcionalitetit, veçanërisht për të miturit në konflikt me ligjin.

5.1.5 Rekomandohet rritja e zbatimit të instituteve procedurale të gjyqimit me marrëveshje, urdhrin penal dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, duke adresuar pengesat procedurale të identifikuar, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe uljen e ngarkesës së sistemit gjyqësor.

5.1.6 Rekomandohet që prokuroria të ndërmarrë masa të fuqishme për të garantuar respektimin e të drejtave procedurale të personave në hetim dhe të të pandehurve, përfshirë shmangien e ndalimeve arbitrare dhe të pajustificuar, si dhe forcimin e



kapaciteteve dhe të kontrollit gjyqësor të veprimeve procedural.

5.1.7 Rekomandohet finalizimi dhe zbatimi i strategjisë së transparencës, duke siguruar që materialet informuese mbi procedurën penale të jenë të qarta, të përditësuara dhe të aksesueshme në formate të ndryshme, përfshirë digjitalisht dhe në gjuhë të thjeshtuar. Gjithashtu, rekomandohet forcimi i kapaciteteve hetimore dhe bashkëpunimit ndërinstytucional, në përputhje me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e profesionistëve të medias.

5.1.8. Rekomandohet forcimi i kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore nëpërmjet një programi të konsoliduar dhe sistematik trajnimesh, të koordinuar me Shkollën e Magjistraturës, me fokus të posaçëm në hetimin financiar, krimin kibernetik, drejtësinë për të mitur, masat e sigurimit dhe të drejtat e njeriut.

5.1.9. Të ndërmerren masa konkrete për rritjen e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe në veçanti të oficerëve të policisë gjyqësore, përmes zhvillimit dhe zbatimit të trajnimeve të specializuara mbi hetimin dhe ndjekjen penale të veprave që lidhen me dhunën ndaj gazetarëve, përfshirë incidentet gjatë protestave, në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut, si dhe përmes forcimit të zbatimit të udhëzimeve të detyrueshme dhe përmirësimit të mekanizmave të mbledhjes dhe raportimit të të dhënave.

5.2 Forcimi i luftës kundër kriminalitetit

5.2.1 Rekomandohet rritja e numrit të hetimeve të filluara kryesisht nga prokurorët, veçanërisht në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, duke forcuar rolin proaktiv të prokurorit dhe përdorimin sistematik të metodave moderne të hetimit, si mjet për të ulur varësinë nga referimet e institucioneve të tjera.

5.2.2. Rekomandohet përmirësimi i cilësisë së hetimeve kundër korrupsionit, rritja e hetimeve proaktive dhe e numrit të çështjeve të dërguara për gjykim, me fokus të veçantë në korrupsionin e nivelit të lartë, duke përfshirë veprat penale në fushën e evazionit fiskal dhe mosdeklarimit tatimor, si dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional.

5.2.3. Rekomandohet intensifikimi i hetimeve financiare paralele, që nga momenti i regjistrimit të procedimit penal, rritja e kërkesave për sekuestrim, përfshirë ato në pronësi të personave të tretë, si dhe rritja e konfiskimeve përfundimtare të aseteve

kriminale, duke siguruar që sekuestrimi paraprak të bazohet në një hetim financiar të qëndrueshëm dhe të mos cenojë aktivitetin e ligjshëm ekonomik.

5.2.4. Rekomandohet ngritja e njësive të specializuara për hetimin e krimit kibernetik brenda prokurorive, e shoqëruar me investime në teknologji të avancuara hetimore dhe programe trajnimi të vazhdueshëm, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës dhe partnerët ndërkombëtarë.

5.2.5. Rekomandohet forcimi i luftës kundër krimit të organizuar nëpërmjet bashkëpunimit të qëndrueshëm me shtetet anëtare të BE-së dhe agjencitë ndërkombëtare. Gjithashtu, rekomandohet rritja e hetimeve për veprat penale të trafikimit, me theks të veçantë për trafikimin e të miturve si kategori vulnerabël, duke përdorur metoda speciale hetimi.

5.2.6. Rekomandohet rritja e procedimeve të regjistruara dhe të dërguara për gjykim për veprat penale në fushën e narkotikëve, duke diferencuar veprat me sasi minimale nga ato të kultivimit dhe trafikimit, dhe duke zbatuar politikë penale të ashpër për këto të fundit.

5.2.7. Rekomandohet forcimi i vëmendjes hetimore për veprat penale në fushën e terrorizmit, duke mbajtur në konsideratë situatën globale të sigurisë dhe duke intensifikuar bashkëpunimin me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në këtë fushë.

5.2.8. Rekomandohet rritja e hetimeve financiare për pastrim parash, e numrit të sekuestimeve dhe konfiskimeve, si dhe përmirësimi i teknikave hetimore dhe i sistemeve të ekspertimit, me fokus të veçantë në format e reja të pastrimit të parave, përfshirë asetet virtuale dhe kriptovalutat.

5.2.9. Rekomandohet ashpërsimi i mëtejshëm i politikës penale për veprat me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese, për rastet e dhunës dhe trafikimit të fëmijëve dhe grave, si dhe për dhunën në familje, veçanërisht ndaj autorëve recidivistë dhe në rastet e kryera në prezencë të të miturve.

5.2.10. Rekomandohet vijimi i vëmendjes së shtuar ndaj veprave penale zgjedhore, duke garantuar hetim të shpejtë dhe efikas, koordinim institucional efektiv dhe reagim proaktiv ndaj shkeljeve që cenojnë integritetin e procesit demokratik.

5.2.11. Rekomandohet intensifikimi i hetimeve dhe ndjekjes penale për veprat që prekin shëndetin publik dhe mjedisin, duke trajtuar me përparësi



shkeljet e sigurisë ushqimore dhe krimet mjedisore, nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me institucionet kompetente dhe rritjes së numrit të procedurave të dërguara për gjykim.

5.2.12. Rekomandohet intensifikimi i hetimeve dhe i ndjekjes penale për veprat penale në fushën e qarkullimit rrugor, në veçanti për drejtimin e mjetit në gjendje të dehur, nën ndikimin e substancave narkotike apo psikotrope, pa leje drejtimi, si dhe për personat që kanë kryer këto vepra në mënyrë të përsëritur (recivistë), si një ndër fenomenet me ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë publike dhe jetën e qytetarëve, duke garantuar reagim të shpejtë dhe efektiv, rritje të cilësisë së hetimeve dhe forcim të bashkëpunimit me Policinë e Shtetit.

5.3 Integriteti, përgjegjshmëria dhe transparencja e veprimtarisë së prokurorëve dhe të zyrave të prokurorisë

5.3.1 Rekomandohet që të dyja institucionet të zhvillojnë metoda të qëndrueshme dhe periodike për verifikimin e integritetit dhe profesionalizmit të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe stafit administrativ, përtej procesit të vetingut të reformës, duke garantuar standarde të vazhdueshme kontrolli në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

5.3.2 Rekomandohet rishikimi i akteve të brendshme që rregullojnë punën e prokurorisë dhe miratimi i modeleve standarde të dokumenteve procedurale të përditshme, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare për organet e akuzës, duke siguruar disponueshmërinë e tyre për publikun dhe integritimin në sistemin e ardhshëm CMS.

5.3.3 Rekomandohet forcimi i mekanizmave të brendshëm të shqyrtimit të ankesave dhe referimit të rasteve me indicie të mjaftueshme pranë organeve kompetente, duke standardizuar formatin e ankesës dhe duke publikuar periodikisht statistikën e ankesave dhe rezultateve të hetimeve disiplinore, me qëllim rritjen e llogaridhënies dhe aksesueshmërisë për publikun.

5.3.4 Rekomandohet rishikimi i rregullave të etikës për prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe administratën e prokurorisë, në përputhje me standardet e BE-së, duke siguruar publikimin dhe aksesimin e plotë të tyre, si dhe rritjen e numrit të aktiviteteve trajnuese për njohjen dhe zbatimin praktik.

5.3.5. Rekomandohet përsheptimi i funksionalizimit të plotë të sistemit të menaxhimit të çështjeve në të dyja institucionet, duke garantuar ndarjen e çështjeve me short elektronik, aksesueshmërinë në të dhëna dhe ndërlidhjen me bazat e të dhënave shtetërore.

5.3.6. Rekomandohet hartimi i një metodologjie të unifikuar që përcakton qartë detyrimet për ruajtjen e sekretit hetimor, respektimin e së drejtës së informimit dhe aksesit në dosje, si dhe mbrojtjen e të dhënave personale të subjekteve të hetimit, në përputhje me ligjin nr. 124/2024 dhe standardet ndërkombëtare.

5.4 Sigurimi i eficiencës dhe ngritja e kapaciteteve institucionale

5.4.1 Rekomandohet që Prokuroria e Përgjithshme dhe Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të konsolidojnë seksionet e specializuara për veprat penale komplekse si korrupsion, krime financiare, krimi kibernetik dhe krimi i organizuar; si dhe të finalizojnë e zbatojnë strategjitë institucionale afatmesme, duke i dhënë përparësi reduktimit të çështjeve të prapambetura dhe rritjes së cilësisë së hetimeve.

5.4.2 Rekomandohet rishikimi dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore e teknike hetimore në të dyja institucionet, duke rritur shpërndarjen efikase të burimeve, përdorimin e ekspertizës së specializuar të institucioneve dhe mbështetjen e strukturave ekzistuese me mjete moderne hetimore.

5.4.3 Rekomandohet që Prokuroria e Përgjithshme dhe Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës dhe partnerët ndërkombëtarë, të hartojnë dhe zbatojnë një plan të strukturuar dhe të vazhdueshëm trajnimi, me fokus në luftën kundër korrupsionit, hetimet financiare, krimi kibernetik dhe krimi i organizuar, si dhe të nxisin programet e specializimit dhe shkëmbimit ndërkombëtar të eksperiencave.

5.4.4. Rekomandohet që Prokuroria e Përgjithshme dhe Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të intensifikojnë trajnimet e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore për standardet dhe procedurat e BE-së në fushën e ekstradimit dhe ndihmës së ndërsjellë juridike, duke i konsideruar këto si prioritet institucional, në kuadër të procesit të integritetit evropian.



5.5 Përdorimi i metodave bashkëkohore të hetimit

5.5.1 Rekomandohet që Prokuroria e Përgjithshme dhe Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të intensifikojnë dhe standardizojnë përdorimin e metodave moderne dhe të veçanta të hetimit: përgjiime, vëzhgime, simulime dhe agjentë të infiltruar, duke rritur numrin e rasteve të zbatimit të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare hetimore.

5.5.2 Rekomandohet përsheptimi i modernizimit të infrastrukturës të prokurorive, si dhe integrimi gradual i inteligjencës artificiale për analizimin dhe kryqëzimin e shpejtë të të dhënave, me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë dhe buxhetit të shtetit.

5.5.4 Rekomandohet promovimi dhe zgjerimi sistematik i metodave bashkëkohore të hetimit, përfshirë hetimet proaktive të bazuara në inteligjencën kriminale, analizën financiare dhe pasurore, mbikëqyrjen elektronike dhe teknologjitë digjitale të menaxhimit të provave, si dhe të shoqëruar me trajnime të specializuara dhe rritje të kapaciteteve teknike e profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

5.6 Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë

5.6.1 Rekomandohet vijimi i bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë për hartimin, rishikimin dhe monitorimin e politikave penale dhe dokumenteve strategjike kombëtare, duke formalizuar pikën institucionale të kontaktit për pjesëmarrje të rregullt në grupet e punës dhe duke siguruar kontribut të vazhdueshëm me të dhëna analitike dhe rekomandime praktike.

5.6.2 Rekomandohet miratimi i një protokollit zyrtar për mbledhjen periodike të të dhënave cilësore dhe sasiore nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, duke mbuluar llojin e veprës penale, fazën e procedimit dhe treguesit e efektivitetit, me qëllim unifikimin e burimeve të informacionit dhe mbështetjen e vendimmarrjes strategjike dhe raportimit parlamentar.

5.6.3 Rekomandohet vijimi dhe forcimi i bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë, në cilësinë e autoritetit qendror për ndihmën juridike ndërkombëtare, duke rritur efikasitetin në

ekzekutimin e kërkesave për ekstradim, letërporosi dhe bashkëpunim të ndërsjellë penal.

5.6.4 Rekomandohet formalizimi i bashkëpunimit ndërmjet prokurorisë dhe shërbimit të ndihmës juridike nëpërmjet mekanizmave të qartë koordinimi, me qëllim identifikimin dhe adresimin e pengesave praktike, që cenojnë ushtrimin efektiv të kësaj të drejte, veçanërisht për kategoritë vulnerabël si viktimat e mitura.

5.7 Bashkëpunimi ndërinstitucional

5.7.1 Me gjithë bashkëpunimin ekzistues, Prokuroria e Përgjithshme dhe Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nuk kanë miratuar ende një strategji të përbashkët gjithëpërfshirëse, ndaj rekomandohet që të formalizojnë një kuadër strategjik të përbashkët, për një qasje të koordinuar dhe të qëndrueshme.

5.7.2 Rekomandohet intensifikimi i bashkëpunimit me institucionet e specializuara në fushat e krimit kibernetik, dhunës ndaj grave, krimit financiar e doganor, krimit mjedisor dhe veprave penale në rrjetet sociale etj.

5.7.3 Rekomandohet forcimi i bashkëpunimit sistematik me institucionet përgjegjëse për zbatimin e strategjive kombëtare në fushën e të miturve, viktimave të krimit, antikorrupsionit, trafikimit të qenieve njerëzore dhe sigurisë kibernetike, si dhe të gjitha strategjive të tjera sipas fushave përkatëse.

5.7.4 Rekomandohet që prokuroria, në kuadër të ngritjes së sistemit CAMS, të ndërmarrë hapat e nevojshëm normativë për zgjerimin e marrëveshjeve për shkëmbim reciprok të të dhënave, digjitalizimin e të dhënave dhe ndërthurjen e bazave të të dhënave në të cilat ka akses, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

5.7.5 Rekomandohet rritja e bashkëpunimit operacional ndërmjet prokurorisë, Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit, duke adresuar nevojat specifike të identifikuar nga secili institucion, përfshirë ndërveprimin e platformave PRESTO dhe sistemit policor të menaxhimit të çështjeve.

5.7.6 Rekomandohet vijimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për procesin e vlerësimit të Shqipërisë nga MONEYVAL-i për pastrimin e parave/luftimin e financimit të terrorizmit.

5.8 Bashkëpunimi ndërkombëtar

5.8.1 Bashkëpunimi ndërkombëtar është zgjeruar ndjeshëm gjatë vitit 2025, duke u pasqyruar në volumnin e lartë të praktikave të ekstradimit,



letërporosive dhe kërkesave për ndihmë juridike të ndërsjellë të trajtuara nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Megjithatë, rekomandohet intensifikimi i kapaciteteve operationale dhe burimeve njerëzore të dedikuara për bashkëpunimin ndërkombëtar, për shënjestrimin efektiv të krimit të organizuar dhe krimit ndërkufitar.

5.8.2 Prokuroria e Përgjithshme dhe Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar kanë shënuar progres të dukshëm në bashkëpunimin me agjencitë e BE-së, megjithatë rekomandohet që Prokuroria e Përgjithshme dhe Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të forcojnë më tej angazhimin aktiv ndërkombëtar, duke rritur kapacitetin hetimor kundër krimit kibernetik dhe pastrimit të parave, si dhe parandalimin dhe ndjekjen penale të veprave të trafikimit të qenieve njerëzore.

5.8.3 Rekomandohet që Prokuroria e Përgjithshme dhe Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të vazhdojnë të intensifikojnë krijimin e skuadrave të përbashkëta hetimore për krimet komplekse ndërkombëtare, veçanërisht në vendet jashtë BE-së, ku është identifikuar veprimtaria kriminale e shtetasve shqiptarë.

VENDIM

Nr. 348, datë 13.5.2026

PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR PRIVAT TË ARSIMIT TË MESËM TË LARTË “KRYQI I NDERUAR”, GJIROKASTËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat të arsimit të mesëm të lartë “Kryqi i Nderuar”, Gjirokastrë, në të cilin zhvillohen edhe lëndë fetare, të cilit i është dhënë leje funksionimi me vendimin nr. 279, datë 10.6.1999, të

Këshillit të Ministrave, “Për dhënie leje funksionimi të institucionit arsimor jopublik”.

2. Institucioni arsimor parauniversitar privat i arsimit të mesëm të lartë “Kryqi i Nderuar”, Gjirokastrë, ka këto detyrime:

a) Të pajisë çdo nxënës me dokumentacionin e nevojshëm shkollor, që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar;

b) Të mbulojë të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në zbatim të këtij vendimi;

c) Të kthejë pagesat e kryera (nëse ka) nga prindi/përfaqësuesi ligjor i nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbyshur, që mund të ketë ndaj nxënësit;

ç) Të vërë në dispozicion të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë vendim;

d) Të dorëzojë në Arkivin Shtetëror Vendor të gjithë dokumentacionin që disponon, si dhe të paraqesë në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, një kopje të dokumentacionit e të procesverbalit të dorëzimit të tij, sipas afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

3. Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, nën juridiksionin e të cilit ndodhet shkolla, ka për detyrë:

a) të ngrejë grup pune, brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat të arsimit të mesëm të lartë “Kryqi i Nderuar”, Gjirokastrë;

b) të marrë masat për transferimin e nxënësve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar për të gjithë nxënësit e regjistruar në këtë institucion arsimor;

c) të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar privat.

4. Vendimi nr. 279, datë 10.6.1999, i Këshillit të Ministrave, “Për dhënie leje funksionimi të institucionit arsimor jopublik”, shfuqizohet.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Gjirokastrë-Libohovë, institucioni arsimor parauniversitar privat



i arsimit të mesëm të lartë “Kryqi i Nderuar”, Gjirokastër, dhe Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 349, datë 13.5.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË
VLERËS SË DËMIT DHE TË
DËMSPËRBLIMIT TË PRONARËVE
PËR KAFSHËT E THERURA, TË
ELIMINUARA, TË SHKATËRRUARA E
TË GROPOSURA NGA SËMUNDJA E
MURTAJËS SË RUMINANTËVE TË
VEGJËL NË VITIN 2025**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 49, të ligjit nr. 10465 datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e dëmshpërblimit, në masën e përgjithshme prej 53 345 500 (pesëdhjetë e tre milionë e treqind e dyzet e pesë mijë e pesëqind) lekësh, pronarëve të kafshëve që janë therur, janë eliminuar, janë shkatërruar dhe janë groposur, pasi kanë rezultuar pozitive me sëmundjen e murtajës së ruminantëve të vegjël gjatë vitit 2025, në bazë të analizave të kryera nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, sipas shtojcës I, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pronarët dëmshpërblehen nga buxheti i vitit 2026, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nga shpenzimet korrente, në programin buxhetor 04220 “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit”.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA I

**PRONARËT QË DËMSPËRBLEHEN PËR KAFSHËT E PREKURA NGA SËMUNDJA E
MURTAJËS SË RUMINANTËVE TË VEGJËL (PPR) GJATË VITIT 2025**

Nr.	Fermeri	Krerë	Vlera në lekë
1	Lamir Shehi	200	4 200 000
2	Bajram Meta	365	7 405 000
3	Hyqmet Meta	119	1 206 000
4	Ndriçim Kuka	2	36 000
5	Liman Kuka	7	126 000
6	Nazmi Popshini	4	72 000
7	Hamde Flora	6	108 000
8	Nezir Dedja	8	144 000
9	Shpetim Meta	7	126 000
10	Vladimir Jamaku	28	504 000
11	Liman Visha	11	198 000
12	Halil Heta	4	72 000
13	Fatmir Kurcani	2	36 000
14	Mahmut Kurcani	6	108 000
15	Hamza Pëllumbi	5	90 000
16	Nuri Flora	2	36 000
17	Besnik Flora	12	216 000
18	Arben Mali	6	108 000



19	Durim Visha	14	252 000
20	Agim Bumja	4	72 000
21	Hanke Beka	6	108 000
22	Mexhit Cani	8	144 000
23	Ibrahim Koçi	6	108 000
24	Kujtim Dedja	6	108 000
25	Desara Zogu	90	1 513 000
26	Florian Bode	172	2 882 000
27	Neki Shkembasi	207	3 664 500
28	Elton Hysolli	81	1 438 500
29	Alfred Shameti	46	986 500
30	Tomor Mustafa	195	3 120 000
31	Ikmet Ceco	72	1 152 000
32	Sami Leco	40	603 000
33	Zamir Milani	19	1 083 000
34	Hasan Qokthi	174	3 510 000
35	Aljeza Hoxha	329	17 810 000
Total		2 263	53 345 500

VENDIM**Nr. 350, datë 13.5.2026**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 570, DATË 17.7.2019,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E AGJENCISË
KOMBËTARE TË PYJEVE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 570, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në përmbajtje të vendimit, emërtesa “Ministria e Turizmit dhe Mjedisit” zëvendësohet me fjalët “ministra përgjegjëse për pyjet”.

2. Në kreun III bëhen shtesa dhe ndryshimi, si më poshtë vijon:

a) Pas pikës 5.1 shtohet pika 5.1/1, me këtë përmbajtje:

“5.1/1. Në lidhje me angazhimet e Republikës së Shqipërisë në procesin e integritetit në Bashkimin Evropian:

a) kontribuon në përafrimin dhe zbatimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian në fushën e pyjeve, të biodiversitetit e të ujërave;

b) kryen inventarizimin, monitorimin dhe raportimin e gjendjes së pyjeve, sipas standardeve të Bashkimit Evropian;

c) kontribuon në politikat për ndryshimet klimatike dhe mbrojtjen e biodiversitetit nëpërmjet menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve;

ç) kontribuon për përfitimin nga programet dhe fondet e Bashkimit Evropian, si dhe nxit përdorimin e teknologjive moderne në sektorin pyjor.”.

b) Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Emërimi i drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe marrëdhëniet e punës në këtë pozicion rregullohen sipas dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të AKP-së dhe të agjencive rajonale të saj rregullohen sipas dispozitave të legjislacionit të shërbimit civil.

Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama**

Faqe | 8983

**VENDIM****Nr. 19, datë 9.5.2026****PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT**

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 186, datë 19.3.2026, “Për shpalljen e situatës së veçantë në tregun e hidrokarbureve”; në zbatim të nenit 21/3 dhe nenit 21/5 të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar; si dhe të aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, “Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve të naftës, për benzinë të standardit SSHEN 2282018 dhe gazoil të standardit SSHEN 5902018.

2. Vlera “Premio” zbatohet sipas publikimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të një dite më parë.

3. Çmimet e miratuara nga Bordi, të cilat reflektojnë çmimet e nënprodukteve në Bursë, të publikuara nga agjencia ndërkombëtare “S&P Global Platts” në USD, në kushtet e livrimit FOB Med, detyrimet doganore/tatimore që aplikohen, si dhe marzhe bruto maksimale të tregtimit (përfshijnë edhe TVSH-në), janë çmime tavan/maksimale në zbatim të metodologjisë së përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

4. Çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve, pas zbatimit të metodologjisë të përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, i ndryshuar, janë si më poshtë:

a) Çmimet tavan (max), për shitjen me shumicë të produkteve:

- 185 lekë/litri për gazoilin;

- 170 lekë/litri për benzinën.

b) Çmimet tavan (max), për shitjen me pakicë të produkteve:

- 197 lekë/litri për gazoilin;

- 182 lekë/litri për benzinën.

5. Referuar aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, “Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar, ku është parashikuar, se në rast se çmimi i shitjes me pakicë, për gazoil është më i lartë se 220 lekë/litri, apo për benzinën është më i lartë se 200 lekë/litri, zbatohet niveli 80% i akcizës. Bazuar në zbatimin e metodologjisë sipas pikës 4 të këtij vendimi, çmimet janë nën kufirin e aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, dhe për rrjedhojë niveli i akcizës do të zbatohet i plotë, 100%.

6. Ngarkohet administrata doganore të bëjë zbatimin në sistem të nivelit të plotë të akcizës për produktin gazoil, sipas kodit të NKM-së: 27101944, me 39.376230 lekë/litri, dhe për produktin benzinë, sipas kodeve të NKM-së: 27101245 dhe 27101249, me 39.376230 lekë/litri.

7. Asnjë operator ekonomik nuk mund t'i tregtojë këto nënprodukte mbi çmimet tavan të vendimit të Bordit. Çdo operator ekonomik me shumicë dhe pakicë, është i lirë t'i tregtojë këto nënprodukte me çmime më të ulëta se çmimet tavan/maksimale të miratuara nga Bordi.

8. Efektet e këtij vendimi fillojnë në datë 9.5.2026, ora 14:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe të gazit, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

9. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, ministrisë përgjegjëse për ekonominë, ministrisë përgjegjëse për financat, administratës doganore dhe administratës tatimore.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Enea Karakaci, Arjana Dyrmishi, Ilir Binaj, Besmir Beja, Ilia Gjermani, Mariglen Bregu, Sezar Beqaj, Nimet Veliaj, Dritan Basha, Arlind Fida, Klaudio Gega



VENDIM

Nr. 20, datë 13.5.2026

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE TË GAZIT

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 186, datë 19.3.2026, “Për shpalljen e situatës së veçantë në tregun e hidrokarbureve”; në zbatim të nenit 21/3 dhe nenit 21/5 të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar; si dhe të aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, “Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve të naftës, për benzinë të standardit SSHEN 2282018 dhe gazoil të standardit SSHEN 5902018.

2. Vlera “Premio” zbatohet sipas publikimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të një dite më parë.

3. Çmimet e miratuara nga Bordi, të cilat reflektojnë çmimet e nënprodukteve në Bursë, të publikuara nga agjencia ndërkombëtare “S&P Global Platts” në USD, në kushtet e livrimit FOB Med, detyrimet doganore/tatimore që aplikohen, si dhe marzhe bruto maksimale të tregtimit (përfshijnë edhe TVSH-në), janë çmime tavan/maksimale në zbatim të metodologjisë së përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar.

4. Çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve, pas zbatimit të metodologjisë të përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, i ndryshuar, janë si më poshtë:

a) Çmimet tavan (max), për shitjen me shumicë të produkteve:

- 189 lekë/litri për gazoilin;

- 175 lekë/litri për benzinën.

b) Çmimet tavan (max), për shitjen me pakicë të produkteve:

- 201 lekë/litri për gazoilin;

- 187 lekë/litri për benzinën.

5. Referuar aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, “Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ku është parashikuar, se në rast se çmimi i shitjes me pakicë, për gazoil është më i lartë se 220 lekë/litri, apo për benzinën është më i lartë se 200 lekë/litri, zbatohet niveli 80% i akcizës. Bazuar në zbatimin e metodologjisë sipas pikës 4 të këtij vendimi, çmimet janë nën kufirin e aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, dhe për rrjedhojë niveli i akcizës do të zbatohet i plotë, 100%.

6. Ngarkohet administrata doganore të bëjë zbatimin në sistem të nivelit të plotë të akcizës për produktin gazoil, sipas kodit të NKM-së: 27101944, me 39.376230 lekë/litri, dhe për produktin benzinë, sipas kodeve të NKM-së: 27101245 dhe 27101249, me 39.376230 lekë/litri.

7. Asnjë operator ekonomik nuk mund t'i tregtojë këto nënprodukte mbi çmimet tavan të vendimit të Bordit. Çdo operator ekonomik me shumicë dhe pakicë, është i lirë t'i tregtojë këto nënprodukte me çmime më të ulëta se çmimet tavan/maksimale të miratuara nga Bordi.

8. Efektet e këtij vendimi fillojnë në datë 13.5.2026, ora 18:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe të gazit, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

9. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, ministrisë përgjegjëse për ekonominë, ministrisë përgjegjëse për financat, administratës doganore dhe administratës tatimore.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Enea Karakaci, Arjana Dyrmishi, Ilir Binaj, Besmir Beja, Ilia Gjermani, Mariglen Bregu, Sezar Beqaj, Nimet Veliaj, Dritan Basha, Arlind Fida, Klaudio Gega

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 464 lekë

